

Sadik Krasniqi - Ilir Krasniqi - Sabri Makolli - Nifë Januzaj

Minire Berisha - Bekim Shotani

EDUKATË FIZIKE, SPORTET DHE SHËNDETI 7

LIBRI I MËSUESIT/SËS



Përmbajtja

1. Parathënie
2. Antropometria dhe motorika
3. Atletika
4. Gjimnastika sportive
5. Gjimnastika ritmike
6. Vallëzimi
7. Karate
8. Xhudo
9. Tennis
10. Ping-pong
11. Badminton
12. Gara
13. Aktivitete në ujë-not
14. Aktivitete në borë- ski
15. Basketboll
16. Futboll
17. Volejboll
18. Hendboll
19. Disa garesa të vogël
20. Ushqimi dhe shprehitë e të ushqyerit
21. Substancat dhe medikamentet
22. Mjedisi natyror dhe artificial

PARATHËNIE

(EDHE PAK PËR KOMPETENCAT, FINALIZIMI NË NIVEL SHKALLE .)

Libri i klasës së shtatë bazohet në përmbajtjet kurrikulare të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë së Kosovës. Mësimdhënësit e lëndës së edukatës fizike, sportit dhe shëndetit, nëpërmjet zbatimit të detyrave programore për klasën e shtatë synojnë që të arrijnë objektivat për transformimin e fëmijëve të klasës së shtatë. Objektivat e arsimtarit të edukimit fizik arrihen nëpërmjet formave bashkëkohore të organizimit të mësimi, realizimit të orëve mësimore me metodologji bashkëkohore dhe me profesionalizëm të lartë. Libri i mësuesit është i bazuar kryesisht në librine nxënësit i cili ofron material të pasur edhe për mësimdhënësit. Krahas mësimdhënies, arsimtari i Edukatës Fizike në bashkëpunim me nxënësit në fillim të vitit shkollor i evidenton të dhënat bazike për nivelin e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve të klasës së shtatë, me qëllim të përcjelljes dhe ndryshimit sa më cilësor të tyre. Institucionet arsimore duhet që sipas mundësive t'i krijojnë kushtet sa më të mira për realizimin e përmbajtjeve programore të edukimit fizik dhe sportiv. Arsimtarët duhet që t'orientojnë fëmijët në sportet për të cilat ata kanë afinitet. Arsimtarët duhet të kenë vazhdimisht parasysh që nëpërmjet metodave dhe përmbajtjeve programore të ndikojnë në zhvillimin e fëmijëve si në aspektin e zhvillimit motorik, biologjik, në mirëqenien, në socializimin e tyre, në krijimin e emocioneve pozitive dhe të vullnetit të mirë. Përmbajtjet programore të klasës së shtatë përveç që ofrojnë njohuri të reja motorike dhe sportive, ndihmojnë në ngritjen e përvetësimit, dhe automatizimit të tyre edhe më lart, duke ndikuar në zhvillimin motoriko- koordinativ dhe të gjithanshëm të fëmijëve.



TEMA 1

Antropometri dhe motorikë – Matje

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti **Fusha:** _____ **Lënda:** _____ **Shkalla:** 3 **Klasa:** VII

TEMA:
Antropometria dhe motorika

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Përshkruan dhe krahason rezultatet antropometrike si dhe i komenton të gjeturat.

NJËSIA MËSIMORE : Matjet antropometrike - Peshë gjatësi, perimetër

RNSH: : I. 6 II, 7 III. 1, 5, V. 9

RNF: *Shpjegon dhe analizon veprime konkrete për ruajtjen e mirëqenies fizike, psikike, emocionale dhe sociale të tij/saj dhe të tjerëve si në familje, me kolegët dhe anëtarët e komunitetit në situata të ndryshme.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Njeh llojin e parametrave antropometrikë si dhe mënyrën e matjes së tyre
- Kupton zhvillimin e tyre në raport me moshën dhe gjininë

Kriteret e suksesit:

- Njeh dhe përdor instrumentet për matje antropometrike
- Dallon parametrat antropometrikë dhe motorikë
- Kupton ekzistimin e dallueshmërisë në bazë të tipave

FJALËT KYÇE:

Trupi, matje, gjatësi, perimetër, zhvillim etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, peshorja, metri,

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Jeta dhe puna

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

Nxënësit përgatisin ambientin dhe mjetet e matëse së bashku me arsimtarin dhe në proces komentojnë për llojet e mjeteve dhe matjet që kryejnë, si dhe mënyrën e drejtë të përdorimit të tyre për matjet konkrete.

PJESA KRYESORE:

Nxënësit ndahen në dy grupe/rreshta:

- Grupin për matje të peshës dhe gjatësisë udhëhiqet nga nxënësit të cilët kryejmë matjet dhe e identifikojnë të dhënat (këto matje tanimë nxënësit mund t'i bëjnë në mënyrë të pavarur sepse është më e thjeshtë dhe e njohur për ta)
- Grupin për matjet të perimetrit dhe indit dhjamor udhëhiqet nga mësuesi, nxënësit kryejnë matjet dhe asistojnë në matjet për nxënësin vijues
- Grupet pasi t'i kryejnë matjet i ndërron vendet dhe rolet.



PJESA PËRFUNDIMTARE:

Nxënësit lexojnë rezultate nga matjet paraprake të një viti më parë, dhe krahasojnë ndryshimet.

AKTIVITETE SHITESË:

Nxënësve u jepet detyrë të analizojnë të dhënat nga viti paraprak duke i krahasuar me të dhënat e reja, ndryshimet për periudhë njëvjeçare

VLERËSIMI

Vlerësohet të kuptuarit e parametrave dhe mënyra e matjes së tyre

TEMA 2

Antropometri dhe motorikë – Matje

Fusha: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Lënda: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA:
Antropometria dhe motorika

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Demonstron shkathtësi motorike gjatë testeve motorike dhe i krahason rezultatet e arritura me rezultatet paraprake.

NJËSIA MËSIMORE : Matjet të aftësive motorike - shpejtësi, forcë, përkulshmëri

RNSH: I. 6 II, 7 III. 1, 5, V. 9

RNF: Shpjegon dhe analizon veprime konkrete për ruajtjen e mirëqenies fizike, psikike, emocionale dhe sociale të tij/saj dhe të tjerëve si në familje, me kolegët dhe anëtarët e komunitetit në situata të ndryshme.

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Njeh llojin e parametrave motorikë si dhe mënyrën e matjes së tyre
- Kupton dallueshmërinë në mes të parametrave antropometrikë dhe motorikë

Kriteret e suksesit:

- Përdor instrumentet për matje antropometrike
- Dallon parametrat antropometrikë dhe motorikë

FJALËT KYÇE:

Trupi, matje, gjatësi, shpejtësi, përkulshmëri, zhvillim etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, metri, kronometri,

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizikë, Jeta dhe puna


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

Nxënësit përgatisin terrenin dhe pajisjet matëse së bashku me mësuesin, diskutojnë për mënyrën e matjeve dhe rezultateve të tyre (si formë e marrjes së parnjohurive lidhur me temën)

PJESA KRYESORE

- Nxënësit ndahen në dy grupe që punojnë paralelisht, grupi A bën matjen e rezultateve në mënyrë të pavaruar për përkulshmësi, forcë eksplozive dhe përsëritëse (tani ata kanë njohuri të mjaftueshme për ta bërë këtë), si dhe evidentojnë të dhënat në formularët e tyre. [ai që përfundon matjen asiston në matjet e nxënësit vijues).
- Grupi B nën udhëheqjen e mësuesit bën matjet për shpejtësi, regjistrojnë të dhënat në formular.
- Pasi t'i kryjnë detyrat, grupet ndërrojnë vendet dhe rolet e tyre



PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit analizojnë rezultate paraprake dhe diskutojnë rreth zhvillimit dhe ndryshimeve

AKTIVITETE SHITESË

Nxënësve u jepet detyrë të analizojnë të dhënat nga viti paraprak duke i krahasuar me të dhënat e reja dhe i vërejnë ndryshimet për periudhën njëvjeçare

VLERËSIMI

Vlerësohet të kuptuarit e aftësive motorike si dhe forma e matjes së tyre.

TEMA 1

Sporte individuale – Atletikë

Edukatë fizike, sportet
Fusha: dhe shëndeti Edukatë fizike, sportet
Lënda: dhe shëndeti Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve individuale

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Përshkruan disiplinat e atletikës.
- Demonstron shkathtësi për realizimin e teknikave në disiplina të ndryshme në atletikë.

NJËSIA MËSIMORE : Teknikat e vrapimeve (gjatësia e hapave, shpejtësia, këndi i trupit, etj.)

RNSH: I. 7, III. 6, V. 4

RNF: *Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përforcuar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- *Demonstron elementet teknike nga disiplinat e atletikës.*

Kriteret e suksesit:

**Pjesëmarrja duhet të jetë aktive në realizimin e teknikave të vrapimeve (gjatësia e hapave , shpejtësia, këndi i trupit et).*

**Shpjegon teknikën e vrapimeve dhe demonstron teknikat e vrapimeve (gjatësia e hapave , shpejtësia, këndi i trupit etj).*

FJALËT KYÇE:

Pozita , nisja , trupi, qëndrimi, pesha.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, poligoni sportiv

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Fizikë, Gjeografi, Jeta dhe puna

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE


** Prezantimi i temës mësimore, nxjerrim paranojë për përmes pyetjeve si : çfarë mendoni ju rreth teknikave të vrapimeve? Çka duhet të ushtrojmë për zhvillimin e gjatësisë së hapave, shpejtësisë, këndi i trupit, etj. Pastaj së bashku me nxënësit i hartojmë kriteret e suksesit duke u bazuar në rezultatet e pritura . Më pas, nxënësit i orientojmë te vendet e tyre ku duhet ta realizojnë këtë njësi mësimore .*

PJESA HYRËSE

**Nxënësit bëjnë përgatitjen (nxehtjen) e trupit përmes aktiviteteve sportive si : vrapimeve, ushtrimeve të formimit, ecjeve etj.*

PJESA KRYESORE

Gjatësia e hapave të vrapimit luan rol të veçantë në përdorimin e energjisë maksimale të vrapimit. Hapi juaj i vrapimit duhet të jetë i gjatë aq sa shputa juaj, duhet te vendoset në tokë, nën qendrën e rëndimit të trupit tuaj, e që këtë e definon përsosmëria e teknikës së vrapimit. Gjatësia e hapave dallon në mes individëve dhe gjatësisë së këmbëve si dhe nga **shpejtësia e vrapimit**. Duhet të dini se nuk duhet zgatur hapin e vrapit me çdo kusht, për të vrapuar sa më shpejt, por këtë duhet ta bëni jo përmes vrapimit me forcë apo me dhunë. Tërë kjo, është e lidhur ngushtë me teknikën optimale të vrapimit, ku i tërë **trupi duhet të jetë pak i përkulur para**, ndërsa shpina duhet të jetë e drejtë, jo e kërrusur, ndërsa, krahët duhet të lëvizin në harmoni me ritmin e vrapimit.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Në përgjithësi, është realizuar e gjithë përmbajtja e planifikuar duke pasur parasysh detyrat e shtëpisë që u janë caktuar nxënësve , përmes të cilave nxënësit do t'i përforcojnë njohuritë e tyre për njësinë mësimore që është zhvilluar.

AKTIVITETE SHITESË

** Në fund të orës, mësuesi i jep detyra nxënësve, secili nxënës duhet të hartojë një plan për organizimin e teknikave të vrapimit.*

VLERËSIMI

**Vlerësimi motivues. Vlerësimi i ndërsjellë dhe lista e kontrollit, mësuesi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe me vlerësim në formë gojore i njofton për lëvizjet e gabuara.*

TEMA 2

Sporte Individuale – Atletikë

Fusha: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve individuale

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Përshkruan disiplinat e atletikës.
- Demonstron shkathtësi për realizimin e teknikave në disiplina të ndryshme në atletikë.

NJËSIA MËSIMORE : Vrapimet e shpejta 60m sprint, hyrja në cak

RNSH: I. 7, V. 4

RNF: *Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përforcuar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- *Demonstron elementet teknike nga disiplinat e atletikës.*

Kriteret e suksesit:

**Pjesëmarrja duhet të jetë aktive në realizimin e teknikës së vrapimeve të shpejta 60m sprint dhe hyrja në cak.*

**Shpjegon teknikën e vrapimit dhe demonstroi teknikën e vrapimeve të shpejta.*

FJALËT KYÇE:

Pozita , nisja , trupi , qëndrimi, pesha.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, poligoni sportiv

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Fizikë, Gjeografi, Jeta dhe puna

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

** Prezantimi i temës mësimore, nxjerrim paranjohuritë përmes pyetjeve si : çfarë mendoni ju rrethvrapimeve te shpejta 60m? Çka duhet te ushtrojmë për zhvillimin e shpejtësisë. Pastaj së bashku me nxënësit i hartojmë kriteret e suksesit duke u bazuar ne rezultatet e pritura. Më pas, nxënësit i orientojmë te vendet e tyre ku duhet ta realizojmë këtë njësi mësimore .*

PJESA HYRËSE

**Nxënësit bëjnë përgatitjen (nxehtjen) e trupit përmes aktiviteteve sportive si: vrapimeve , ushtrimeve te formimit, ecjeve etj.*

PJESA KRYESORE

**Mësimdhënësi shpjegon dhe demonstroi së pari teknikën e vrapimit. Nxënësit ndahen në grupe dhe fillojnë ekzekutimin e formave të ndryshme të vrapimeve. Nxënësit zhvillojnë lojë e ashtuquajtur vrapo dhe dëno duke ushtruar vrapimet e shkurtra-shpejta.*

**Vrapimet e shpejta në shtigje të shkurta mund të jenë në: 60, 100, 200, 400 metra si dhe këto vrapime fillojnë nga starti i ulët.*



PJESA PËRFUNDIMTARE

Në përgjithësi është realizuar e gjithë përmbajtja e planifikuar duke pasur parasysh detyrat e shtëpisë që u janë caktuar nxënësve, përmes të cilave nxënësit do t'i përforcojnë njohuritë e tyre për njësinë mësimore që është zhvilluar.

AKTIVITETE SHITESË

** Në fund të orës mësimdhënësi jep detyra për nxënësit, secili nxënës duhet të hartojë një plan për organizimin e njohurive për vrapimet e shkurtra-shpejta 60m.*

VLERËSIMI

- *Vlerësimi motivues. Vlerësimi i ndërsjellë dhe lista e kontrollit, mësimdhënësi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe me vlerësim në formë gojore i njofton për lëvizjet e gabuara.*

TEMA 3

Spporte Individuale – Atletikë

Fusha: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Lënda: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve individuale

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Përshkruan disiplinat e atletikës.
- Demonstron shkathtësi për realizimin e teknikave në disiplina të ndryshme në atletikë.

NJËSIA MËSIMORE : Vrapimet e Qëndrueshmërisë

RNSH: I. 3, III. 6 , V. 4

RNF: *Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përforcuar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- *Demonstron elementet teknike nga disiplinat e atletikës.*

Kriteret e suksesit:

**Pjesëmarrja është aktive në realizimin e teknikës së vrapimeve në shtigje të mesme dhe të gjata.*

**Shpjegon teknikën e vrapimeve të qëndrueshmërisë.*

FJALËT KYÇE:

Qëndrimet, këmba, trupi, kthesa, forca, qendra etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, poligoni sportiv

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Fizikë, Gjeografi, Jeta dhe puna

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

Prezantimi i temës mësimore, nxjerrim paranojohuritë përmes pyetjeve si : çfarë mendoni ju rreth vrapimeve në shtigje të gjata? Çka duhet të ushtronim për zhvillimin e vrapimeve në shtigje të gjata. Pastaj së bashku me nxënësit i hartojmë kriteret e suksesit duke u bazuar në rezultatet e pritura. Më pas nxënësit i orientojmë te vendet e tyre ku duhet ta realizojmë këtë njësi mësimore .

PJESA HYRËSE

- *Nxënësit bëjnë përgatitjen (nxehtjen) e trupit përmes aktiviteteve sportive si: vrapimeve, ushtrimeve të formimit, ecjeve etj.*

PJESA KRYESORE

Mësimdhënësi shpjegon dhe demonstroi së pari teknikën e vrapimit në shtigje të gjata. Nxënësit ndahen në grupe dhe fillojnë ekzekutimin e formave të ndryshme të vrapimeve. Nxënësit zhvillojnë lojën e ashtuquajtur `vrapo dhe luaj` duke ushtruar vrapimet në shtigje të gjata.



PJESA PËRFUNDIMTARE

** Në përgjithësi është realizuar e gjithë përmbajtja e planifikuar duke pasur parasysh detyrat e shtëpisë që u janë caktuar nxënësve, përmes të cilave nxënësit do t'i përforcojnë njohuritë e tyre për njësinë mësimore që është zhvilluar.*

AKTIVITETE SHITESË

- *Secili nxënës duhet që të hulumtojë në internet dhe të shikojë video të ndryshme në youtube për mënyrën se si bëhet realizimi i këtyre teknikave të vrapimeve ..*

VLERËSIMI

**Vlerësimi motivues. Vlerësimi i ndërsjellë dhe lista e kontrollit, mësimdhënësi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe me vlerësim në formë gojore i njofton për lëvizjet e gabuara.*

TEMA 4

Sporte Individuale – Atletikë

Fusha: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve individuale

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Përkshkruan disiplinat e atletikës.
- Demonstron shkathtësi për realizimin e teknikave në disiplina të ndryshme në atletikë.

NJËSIA MËSIMORE : Vrapim kros vjeshtor

RNSH: I-2, 5, 8 II-2, 5, 7.

RNF: *Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përfshirë shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- *Demonstron elementet teknike nga disiplinat e atletikës.*

Kriteret e suksesit:

** Nxënësit ta kontrollojnë mirë hapësirën dhe kohën gjatë vrapimit.*

- *Demonstron për kohën e vrapimit të paktën një herë*
- *Demonstron për gjatësinë e shtegut të paktën një herë*
- *Demonstron për punën e frymëmarrjes dhe frymënxjerrjes të paktën një herë*

FJALËT KYÇE:

Vrapim , kros , koha,qëndrimet, këmba, trupi, forca, qendra etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, poligoni sportiv.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Fizikë, Biologji,Jeta dhe puna

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

- *Prezantimi i temës mësimore, nxjerrim paranjohuritë përmes pyetjeve si : çfarë mendoni ju rreth vrapimit kros, pastaj së bashku me nxënësit i hartojmë kriteret e suksesit duke u bazuar në rezultatet e pritura. Më pas, nxënësit i orientojmë të shtegu i vrapimit (krosi) .*

PJESA HYRËSE

** Rreshtimi i nxënësve, vrapim rreth fushës, ecje, vrapime, nxehe te ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme, zgjatje, përgatitje e organizmit për pjesën kryesore*

PJESA KRYESORE

**Mësimdhënësi i njofton nxënësit me njësinë mësimore dhe paraqet para tyre rezultatet e të nxënësve, distancën e vrapimit për femra 800m dhe për meshkuj 1000m, dhe kohën e paraparë për të hyrë në cak.*

**Mësimdhënësi do të japë për secilin nxënës informacion kthyes me gojë për performancën e shfaqur në kros.*



PJESA PËRFUNDIMTARE

** Në përgjithësi është realizuar e gjithë përmbajtja e planifikuar duke pasur parasysh detyrat e shtëpisë që u janë caktuar nxënësve, përmes të cilave nxënësit do t'i përforcojnë njohuritë e tyre për njësinë mësimore që është zhvilluar.*

AKTIVITETE SHITESË

** Në fund të orës mësimdhënësi jep detyra për nxënësit , secili nxënës duhet të hartojë një plan për organizimin e njohurive për vrapimin në natyrë, krosin.*

VLERËSIMI

**Vlerësimi motivues. Vlerësimi i ndërsjellë dhe lista e kontrollit, mësimdhënësi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe me vlerësim në formë gojore i njofton për lëvizjet e gabuara.*

TEMA 5

Sporte Individuale – Atletikë

Edukatë fizike, sportet
Fusha: dhe shëndeti

Edukatë fizike, sportet
Lënda: dhe shëndeti

Shkalla: 3

Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve individuale

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Përshkruan disiplinat e atletikës.
- Demonstron shkathtësi për realizimin e teknikave në disiplina të ndryshme në atletikë.

NJËSIA MËSIMORE : Teknika e dorëzim-pranimit të stafetës, (bazat)

RNSH: I. 1, V. 4

RNF: *Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përforcuar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- *Demonstron elementet teknike nga disiplinat e atletikës.*

Kriteret e suksesit:

** Nxënësit ta kontrollojnë mirë hapësirën dhe kohën gjatë vrapimeve stafetare*

- *Demonstron teknikën e dorëzim-pranimit të stafetës të paktën një herë*
- *Demonstron për gjatësinë e shtegut të paktën një herë*

FJALËT KYÇE:

Qëndrimet, këmba, trupi, forca, stafeta etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, poligoni sportiv

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Fizikë, Gjeografi, Jeta dhe puna

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

- Prezantimi i temës mësimore, nxjerrim parnjohuritë përmes pyetjeve si : çfarë mendoni ju rreth dorëzim-pranimit të stafetës, pastaj së bashku me nxënësit i hartojmë kriteret e suksesit duke u bazuar në rezultatet e pritura. Më pas nxënësit i orientojmë te shtegu i vrapimeve stafetare (dorëzim-pranimit të stafetës) .


PJESA HYRËSE

**Nxënësit bëjnë përgatitjen (nxehjen) e trupit përmes aktiviteteve sportive si : vrapimeve, ushtrimeve të formimit, ecjeve etj.*

Vrapimi me stafetë nuk dallon nga vrapimi pa stafetë, sepse dorëzim-pranimi nuk duhet të ndikojë në mënyrën dhe teknikën e vrapimit. Për këtë arsye duhet të ushtrohet dorëzimi dhe pranimi i stafetës.

PJESA KRYESORE

Dorëzim-pranimi i stafetës paraqet elementin më të rëndësishëm të vrapimeve stafetare. Ajo duhet të ekzekutohet në atë mënyrë që stafeta të kalojë rrugën nga fillimi e deri në fund të garës, pa ndërprerje, pa ndalje, pa dështime, ngjashëm sikur stafetën ta kishte bartur një garues i vetëm.



Dorëzim –pranimi i stafetës

PJESA PËRFUNDIMTARE

**Në përgjithësi është realizuar e gjithë përmbajtja e planifikuar duke pasur parasysh detyrat e shtëpisë që u janë caktuar nxënësve, përmes të cilave nxënësit do t'i përforcojnë njohuritë e tyre për njësinë mësimore që është zhvilluar.*

AKTIVITETE SHITESË

** Secili nxënës duhet që të hulumtojë në internet dhe të shikojë video të ndryshme në youtube për mënyrën se si bëhet realizimi i këtyre teknikave të dorëzim-pranimit të stafetës.*

VLERËSIMI

**Vlerësimi motivues. Vlerësimi i ndërsjellë dhe lista e kontrollit, mësimdhënësi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe me vlerësim në formë gojore i njofton për lëvizjet e gabuara.*

TEMA 6

Sporte Individuale – Atletikë

Fusha: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve individuale

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Përshkruan disiplinat e atletikës.
- Demonstron shkathtësi për realizimin e teknikave në disiplina të ndryshme në atletikë.

NJËSIA MËSIMORE : Përvetësimi i hedhjes së gjyles.

RNSH: I. 5. 7, II. 3. 7, V. 2

RNF: *Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përfunduar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- *Demonstron elementet teknike nga disiplinat e atletikës.*

Kriteret e suksesit:

**Demonstron dhe tregon për fazën e përgatitjes të paktën tri herë*

**Demonstron dhe tregon për fazën e përpjekjes maksimale të paktën tri herë*

**Demonstron dhe tregon për fazën e mbajtjes së baraspeshës të paktën tri herë.*

**Demonstron dhe tregon për fazën e shtytjes së gjyles të paktën tri herë*

FJALËT KYÇE:

faza e përgatitjes, faza e shtytjes së gjyles, faza e përpjekjes maksimale, faza e mbajtjes së baraspeshës

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, poligoni sportiv

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Fizikë, Gjeografi, Jeta dhe puna

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

Qëllimi i hedhjes së gjyles në atletikë është që nëpërmjet aftësive psiko-motorike dhe teknike të arrihet rezultat sa më i mirë në hedhjen e gjyles sa më larg.

PJESA HYRËSE

**Përgatitni nyjat para hedhjeve, lëvizni krahët dhe nyjat e shuplakave në të gjitha drejtimet*

** Përgatite shtyllën kurrizore me disa ushtrime, përkulje para, mbrapa, majtas, djathtas, përdredhje e lakime në të majtë e në të djathtë.*

**Peshoni gjylen duke e hedhur prej dorës në dorë, lart dhe përsëri në të njëjtën dorë;*

**Hidhe gjylen vetëm nga krahu, thjesht, në një ambient natyror, fushë të hapur*

**Hidhe gjylen me të dy duart.*


**Provo, hidhe gjylen edhe me dorën jo të preferuar.*

PJESA KRYESORE

** Vendosja në rreth, në vijën e fundit, drejtqëndrim, me shpinë të kthyer në drejtim të hedhjes, gjylja e vendosur në qafë, krahu i hovit lart, i shtrirë.*

** Përkulje para me trupi dhe mbledhje e lehtë e këmbës së majtë, qëndrim mbi këmbën e djathtë, koka poshtë, krahu pak në hark.*

** Shpërthim eksploziv duke e shtrirë këmbën e majtë në drejtim të hedhjes, dhe tërheqje zvarrë e këmbës mbështetëse në drejtim të hedhjes, kthim me rotacion nga poshtë-lart në të majtë, në drejtim të hedhjes, bartje e peshës nga këmba e djathtë në të majtën, hidhet ashpër gjylja duke e shtrirë krahun e djathtë (gjyles) me ashpërsi në drejtim sa më larg. Në të njëjtën kohë kur gjylja shkëputet nga dora, bëhet edhe ndërrimi i peshës nga këmba e majtë në të djathtë.*



PJESA PËRFUNDIMTARE

** Ne përgjithësi janë arritur të gjitha rezultatet për shtytjen e gjyles pasi që të gjithë nxënësit ishin shumë aktivë dhe të kënaqur me rezultatet e arritura.*

AKTIVITETE SHITESË

** Në fund të orës mësimdhënësi jep detyra për nxënësit , secili nxënës duhet të hartojë një plan për organizimin e njohurive për shtytjen e gjyles dhe të shikojë në YouTube video të ndryshme të hedhjes së gjyles.*

VLERËSIMI

**Vlerësimi motivues. Vlerësimi i ndërsjellë dhe lista e kontrollit, mësimdhënësi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe me vlerësim në formë gojore i njofton për lëvizjet e gabuara.*

TEMA 7

Sporte Individuale – Atletikë

Edukatë fizike, sportet
Fusha: dhe shëndeti Edukatë fizike, sportet
Lënda: dhe shëndeti Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve individuale

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Përshkruan disiplinat e atletikës.
- Demonstron shkathtësi për realizimin e teknikave në disiplina të ndryshme në atletikë.

NJËSIA MËSIMORE : Vrapim, krosi pranveror

RNSH: I-2, 5, 8 II-2, 5, 7.

RNF: *Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përfshirë shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- *Demonstron elementet teknike nga disiplinat e atletikës.*

Kriteret e suksesit:

- *Demonstron për vrapimin në kros të paktën një herë*
- *Demonstron për kohën e vrapimit të paktën një herë*
- *Demonstron për gjatësinë e shtegut të paktën një herë*
- *Demonstron për punën e frymëmarrjes dhe frymënxjerrjes të paktën një herë*

FJALËT KYÇE:

Vrapim , kros , koha,qëndrimet, këmba, trupi, forca, qendra etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, poligoni sportiv

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Fizikë, Gjeografi, Jeta dhe puna.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

- *Prezantimi i temës mësimore, nxjerrim paranojë për përmes pyetjeve si : çfarë mendon ju rreth vrapimit në kros pranveror, pastaj së bashku me nxënësit i hartojmë kriteret e suksesit duke u bazuar në rezultatet e pritura. Më pas nxënësit i orientojmë te shtegu i vrapimit (kros).*

PJESA HYRËSE

** Rreshtimi i nxënësve, vrapim rreth fushës, ecje, vrapime, nxehe të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme, zgjatje, përgatitje e organizmit për pjesën kryesore.*

PJESA KRYESORE

**Mësimdhënësi i njofton nxënësit me njësinë mësimore dhe paraqet para tyre rezultatet e të nxënësve, distancën e vrapimit për femra 800m dhe për meshkuj 1000m, dhe kohën e paraparë për të hyrë në cak.*

**Mësimdhënësi do të japë për secilin nxënësin informacion kthyes me gojë për performancën e shfaqur në kros.*



PJESA PËRFUNDIMTARE

** Në përgjithësi është realizuar e gjithë përmbajtja e planifikuar duke pasur parasysh detyrat e shtëpisë që u janë caktuar nxënësve, përmes të cilave nxënësit do t'i përforcojnë njohuritë e tyre për njësinë mësimore që është zhvilluar.*

AKTIVITETE SHITESË

** Në fund të orës, mësimdhënësi jep detyra për nxënësit, secili nxënësi duhet të hartojë një plan për organizimin e njohurive për vrapimin në natyrë, krosin.*

VLERËSIMI

**Vlerësimi motivues. Vlerësimi indërsjellë dhe lista e kontrollit, mësimdhënësi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe me vlerësim në formë gojore i njofton për lëvizjet e gabuara.*

TEMA 8

Sporte Individuale – Atletikë

Edukatë fizike, sportet
Fusha: dhe shëndeti Edukatë fizike, sportet
Lënda: dhe shëndeti Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve individuale

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Përshkruan disiplinat e atletikës.
- Demonstron shkathtësi për realizimin e teknikave në disiplina të ndryshme në atletikë.

NJËSIA MËSIMORE : Përsosja e teknikës kërcim me trup nëhark

RNSH: V. 3, VI. 3, II. 7.

RNF: *Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përforcuar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- *Demonstron elementet teknike nga disiplinat e atletikës.*

Kriteret e suksesit:

**Demonstron dhe tregon për hapat e vrapimit të paktën dy herë.*

**Demonstron dhe tregon për shtytjen e kërcimit së gjati, trupi në hark, të paktën dy herë.*

**Demonstron dhe tregon për lëvizjen e duarve dhe këmbëve të paktën dy herë.*

FJALËT KYÇE:

Hapat, vrulli, shtytja, kërcimi.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, poligoni sportiv

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Fizikë, Gjeografi, Jeta dhe puna.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

** Të paraqitet dhe shpjegohet teknika e kërcimit me trup në hark*

** Vrull 5-7 hapa, shkëputuni dhe shtrini këmbën e shkëputjes, ndërsa gjurin e këmbës së hovit ngritin para, krahët lart.*

PJESA HYRËSE

** Njoftimi i nxënësve në lidhje me njësinë mësimore, vrapim rreth fushës, nxeheje e ekstremiteteve trupore, zgjatje, përgatitje e organizmit për pjesën kryesore.*

** Përsëritni disa herë para se të filloni ta mësoni kërcimin me trup në hark.*

PJESA KRYESORE

** Kërceni në vend me trup në hark*

** Vendosni dyshekët, merrni vrull dhe kërceni me trup në hark*

** Vrull 7-9 hapa, shkëputje, lësho-drejto këmbën e hovit, tërheq krahët nga mbrapa, shtrirje e këmbëve para. Takim me të dy këmbët në gjysmëpërkulje. Mund të aplikoni edhe rrethrotullim të krahëve, nga mbrapa-para.*

** Kërcim me tërë vrullin dhe me trup në hark, përvetësimi i teknikës në tërësi.*

** Siguroni vendin ku kërceni që të mos paraqesë rrezik për lëndime*



Kërcimi me trup në hark

PJESA PËRFUNDIMTARE

** Në përgjithësi janë arritur të gjitha rezultatet për kërcim së gjati, teknika truphark, pasi që të gjithë nxënësit ishin shumë aktivë dhe të kënaqur me rezultatet e arritura.*

AKTIVITETE SHITESË

** Në fund të orës mësimdhënësi jep detyrat për nxënësit, secili nxënës duhet të hartojë një plan për organizimin e njohurive për kërcim së gjati, teknikat truphark.*

VLERËSIMI

** Vlerësimi motivues. Vlerësimi i ndërsjellë dhe lista e kontrollit, mësimdhënësi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe me vlerësim në formë gojore i njofton për lëvizjet e gabuara.*

TEMA 9

Sporte Individuale – Atletikë

Fusha: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve individuale

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Përshkruan disiplinat e atletikës.
- Demonstron shkathtësi për realizimin e teknikave në disiplina të ndryshme në atletikë.

NJËSIA MËSIMORE : Përsosja e teknikës: kërcim barkushe

RNSH: I. 1. 3, II. 5. 7, V. 3

RNF: *Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përforcuar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- *Demonstron elementet teknike nga disiplinat e atletikës.*

Kriteret e suksesit:

**Demonstron vendosjen për kërcim së larti (barkushe) të paktën tri herë.*

**Demonstron për kërcim së larti (barkushe) të paktën tri herë.*

**Demonstron për rezultatin të paktën tri herë.*

FJALËT KYÇE:

Pozita, nisja, trupi, qëndrimi, pesha

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, poligoni sportiv

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Fizikë, Gjeografi, Jeta dhe puna

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE


* Prezantimi i temës mësimore, nxjerrim paranojohuritë përmes pyetjeve si : çfarë mendoni ju rreth kërcimit në lartësi (barkushe) gërshtë? Çka duhet të ushtronim për zhvillimin e kërcimit. Pastaj së bashku me nxënësit i hartojmë kriteret e suksesit duke u bazuar në rezultatet e pritura. Më pas nxënësit i orientojmë te vendet e tyre ku duhet ta realizojmë këtë njësi mësimore.

PJESA HYRËSE

*Nxënësit bëjnë përgatitjen (nxehjen) e trupit përmes aktiviteteve sportive si : vrapimeve, ushtrimeve të formimit, ecjeve etj. Te teknika e **kërcimit barkushe** për dallim nga teknika gërshtë, vrulli merret nga ana e njëjtë me këmbën e shkëputjes.

PJESA KRYESORE

*Kjo teknikë ekzekutohet me vrull të shpejtë, 5-9 hapa vrap. Nëse shkëputeni me të majtën, vendosuni në anën e majtë të vendkërcimit. Pas shkëputjes, me këmbën e majtë, ngritni këmbën e djathtë – hov, sipër shufrës. Duke e ngritur edhe krahun e djathtë lart, për të bërë rotacion në anën e majtë rreth shufrës horizontale. Në pozitën sipër shufrës, tërhiqni këmbën e shtytjes, për të mos e prekur shufrën. Kërcyesi synon të marrë pozitën horizontale, paralel me shufrën. Pas kërcimit, takimi bëhet mbi krahun, shpatullën dhe kërdhokullën e djathtë, në rrotullim e sipër.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Në përgjithësi është realizuar e gjithë përmbajtja e planifikuar duke pasur parasysh detyrat e shtëpisë që u janë caktuar nxënësve, përmes të cilave nxënësit do t'i përforcojnë njohuritë e tyre për njësine mësimore që është zhvilluar.

AKTIVITETE SHITESË

*Secili nxënës duhet që të hulumtojë në internet dhe të shikojë video të ndryshme në youtube për mënyrën se si bëhet realizimi i këtyre teknikave të kërcimit në lartësi (barkushe).

VLERËSIMI

*Vlerësimi motivues. Vlerësimi i ndërsjellë dhe lista e kontrollit, mësimdhënësi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe me vlerësim në formë gojore i njofton për lëvizjet e gabuara.

TEMA 10

Sporte Individuale – Atletikë

Edukatë fizike, sportet
Fusha: dhe shëndeti

Edukatë fizike, sportet
Lënda: dhe shëndeti

Shkalla: 3

Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve individuale

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Përshkruan disiplinat e atletikës.
- Demonstron shkathtësi për realizimin e teknikave në disiplina të ndryshme në atletikë.

NJËSIA MËSIMORE : Kërcim trehapësh

RNSH: II. 2 - V. 5

RNF: *Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përforcuar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Demonstron elementet teknike nga disiplinat e atletikës.

Kriteret e suksesit:

- Demonstron trehapëshin për të paktën një herë
- Demonstron për gjatë sin' e kërcimit të paktën një herë
- Demonstron për punën e frymëmarrjes dhe frymënxjerrjes të paktën një herë

FJALËT KYÇE:

Trehapëshi, kërcim, vull.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, poligoni sportiv

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Fizikë, Gjeografi, Jeta dhe puna

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE


**Prezantimi i temës mësimore, nxjerrim paranojë për përmes pyetjeve si : çfarë mendoni ju rreth kërcimit trehapësh, pastaj së bashku me nxënësit i hartojmë kriteret e suksesit duke u bazuar në rezultatet e pritura. Më pas, nxënësit i orientojmë te shtegu i kërcim së gjati trehapëshit.*

PJESA HYRËSE

**Njoftimi i nxënësve në lidhje me njësine mësimore, vrapim rreth fushës, nxehe e ekstremiteteve trupore, zgjatje, përgatitje e organizmit për pjesën kryesore.
Përsëritni disa herë para se të filloni ta mësoni kërcimin së gjati- trehapëshin.

PJESA KRYESORE

Trehapëshi është disiplinë e kërcim së gjati i cili realizohet me vrull, duke i bërë tre hapa te njëpasnjëshëm, d. m. th. kërcim prej një rës këmbë në këmbë e njëjtë, hap me këmbën tjetër dhe kërcim në të dy këmbët.



PJESA PËRFUNDIMTARE

** Në përgjithësi është realizuar e gjithë përmbajtja e planifikuar duke pasur parasysh detyrat e shtëpisë që u janë caktuar nxënësve, përmes të cilave nxënësit do t'i përforcojnë njohuritë e tyre për njësine mësimore që është zhvilluar.*

AKTIVITETE SHITESË

**Secili nxënës duhet që të hulumtojë në internet dhe të shikojë video të ndryshme në youtube për mënyrën se si behet realizimi i këtyre teknikave të kërcimit trehapësh.*

VLERËSIMI

**Vlerësimi motivues. Vlerësimi i ndërsjellë dhe lista e kontrollit, mësimdhënësi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe me vlerësim në formë gojore i njofton për lëvizjet e gabuara.*

TEMA 1

GJIMNASTIKË SPORTIVE

Edukatë fizike, sportet
Fusha: dhe shëndeti

Edukatë fizike, sportet
Lënda: dhe shëndeti

Shkalla: 3

Klasa: VII

TEMA:
Gjymnastika sportive

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Shpjegon disiplinat e gjymnastikës sportive
- Demonstron kompozim ushtrimesh të ndryshme me parter, mbi vegla dhe valle të ndryshme.

NJËSIA MËSIMORE : Ecjet me kthim për 90 shkallë, lidhjet lëvizore (vrapime, kërcime, kthime, qëndrime , bartje të peshës etj.)

RNSH: I. 3, III. 6, V. 4

RNF: *Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjymnastikë, sportet luftarake etj.) duke përforcuar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Merr pjesë aktive në kryerje të detyrave të dhëna.
- Kupton mënyrat e ecjet me kthim për 90 shkallë, lidhjet lëvizore
- Kupton vrapime, kërcime, kthime, qëndrime , bartje të peshës

Kriteret e suksesit:

- Vendoset saktë në pozicion anësor, ecjet me kthim për 90 shkallë.
- Arrin ta demonstrojë kthimin
- Analizon arsyen dhe përcakton situatat kur duhet të bëhet kthimi për 90 shkallë.

FJALËT KYÇE:

Qëndrimet, krah, rrotullim, kapërdim, mbështetje etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, dyshekët gjymnastikorë

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Fizikë, Biologji, Jeta dhe puna.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

Vrapim i lehtë rreth fushës me nxehe të ekstremiteteve trupore duke filluar nga lart-poshtë, zgjatje në vend dhe përgatitje e organizmit për pjesën kryesore

PJESA KRYESORE :

Ecjet me kthim për 90 shkallë, lidhja e vrapit me elemente kërcimi, lidhja e elementeve të kthimeve me kërcime, qëndrimi në ekuilibër me bartje të peshës.

Ecja me kthim për 90 shkallë mund të ekzekutohet majtas apo djathtas. Duke bërë hap me të djathtën djathtas, të vendosur mbi gishtërinjtë, bartim peshën e trupit mbi atë këmbë duke e rrotulluar këmbën e majtë rreth gishtave dhe përfundojmë kthimin në qëndrim për të vazhduar ecjen në kahun e ri, djathtas. Kthimet (deri në 360^0) mund të realizohen edhe në kahun tjetër gjatë ecjes apo edhe me kërcime.

VRAPIMI NË AKROBATIKË

Vrapimet në akrobatikë, kryesisht na shërbejnë për të zhvilluar incerinë apo vrullin për kryerje të ndonjë elementi të shkallës më të lartë të vështirësisë, sidomos në rastet kur nevojitet sigurimi i lartësisë, gjatësisë apo i të dyjave bashkë. Vrapimet në akrobatikë shoqërohen edhe me hovin e krahëve me qëllim të bashkëveprimit për krijimin e incersisë dhe vrullit, për të siguruar lartësinë e duhur.

Vrapimi në akrobatikë shërben për lidhjen e elementeve të kthimeve dhe kërcimeve duke përcaktuar vijueshmërinë e tyre në kompozimin e ushtrimeve në dyshe. Kthimet, fillimisht bëhen për 90, 180, 270, dhe pastaj kthimin për 360 gradë për të ndier nivelin e vështirësisë për secilin kthim si dhe për ta ndier edhe lëvizjen .



PJESA PËRFUNDIMTARE Diskutimi për të arritura dhe vështirësitë që u paraqitën gjatë ushtrimeve. Bëjmë zgjatjen e muskujve, relaksimin e muskujve dhe freskohemi me ujë

AKTIVITETE SHITESË

Në fund të orës, mësime dhënësi jep detyra për nxënësit, secili nxënës duhet të hartojë një plan për njohuritë që mund të marrin për gjimnastikën sportive, në formë teorike dhe në praktikë duhet ta përsërisë ushtrimin.

VLERËSIMI

Vlerësimi i ndërsjellë dhe lista e kontrollit, mësime dhënësi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe me vlerësime në formë gojore për lëvizjet e gabuara

TEMA 2

GJIMNASTIKË SPORTIVE

Edukatë fizike, sportet
Fusha: dhe shëndeti

Edukatë fizike, sportet
Lënda: dhe shëndeti

Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA:
Gjymnastika sportive dhe ritmike

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Shpjegon disiplinat e gjymnastikës sportive
- Demonstron kompozim ushtrimesh të ndryshme me parter, mbi vegla dhe valle të ndryshme.

NJËSIA MËSIMORE : Kapërdimi para, nga vertikalia mbi krahë, dhe me këmbë të hapura

RNSH: I. 3, III. 6, V. 4

RNF: *Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjymnastikë, sportet luftarake etj.) duke përforcuar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Merr pjesë aktive në kryerje të detyrave të dhëna.
- Kupton mënyrat e kapërdimit
- Kupton lëvizje mbi vertikale

Kriteret e suksesit:

- Vendoset saktë në pozicion
- Koordinon lëvizjet
- Analizon arsyen dhe përcakton situatat kur përdoret kapërdimi nga vertikalia dhe menaxhon lëvizjet e këmbëve.

FJALËT KYÇE:

Qëndrimet, krah, rrotullim, kapërdim, mbështetje etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, dyshekët gjymnastikorë

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Fizikë, Biologji, Jeta dhe puna.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

Vrapim i lehtë rreth fushës për nxehtë të ekstremiteteve trupore duke filluar nga lart-poshtë, zgjatje në vend dhe përgatitje e organizmit për pjesën kryesore

PJESA KRYESORE

1. Paraqitja e teknikës
Kapërdim mbrapa me këmbë të shtrira të cilat kur gjenden në pozicionin horizontal duhet të shtrihen mbrapa-lart, duke u ndihmuar edhe nga shtrirja e krahëve me qëllim të kalimit në pozicionin e vertikales mbi duar. Varianti i dytë kalohet në pozicionin me këmbë të hapura.
2. Ushtrimi bazë – shtrirje në shpinë, mbledhje e këmbëve të shtrira mbrapa-lart me shtyrje deri në vertikale mbi duar.
3. Asistimi dhe përkujdesja: arsimtari ndihmon duke i qëndruar ushtruesit anash dhe duke e ndihmuar për këmbë në fazën e shpalosjes gjatë ngritjes së këmbëve për të kaluar në vertikale mbi krahë.



Asistimi dhe përkujdesja: arsimtari ndihmon duke e mbajtur për beli në fazën e ekzekutimit të vertikales mbi krahë dhe rënies në kapërdim para

PJESA PËRFUNDIMTARE Diskutimi për të arriturat dhe vështirësitë që u paraqitën gjatë ushtrimeve. Bëjmë zgjatjen e muskujve, relaksim të muskujve dhe freskohemi me ujë

AKTIVITETE SHITESË

Në fund të orës, mësuesi jep detyra për nxënësit, secili nxënës duhet të hartojë një plan për njohuritë që mund të marrin për gjimnastikën sportive në formë teorike dhe praktike. Përsërisin ushtrimin.

VLERËSIMI

Vlerësimi i ndërsjellë dhe lista e kontrollit, mësuesi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe me vlerësime në formë gojore për lëvizjet e gabuara

TEMA 3

GJIMNASTIKË SPORTIVE

Fusha: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA:

Gjimnastika sportive dhe ritmike

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Shpjegon disiplinat e gjimnastikës sportive
- Demonstron kompozim ushtrimesh të ndryshme me parter, mbi vegla.

NJËSIA MËSIMORE : Kapërdimi mbrapa, deri në vertikale dhe me këmbë hapur

RNSH: I. 3, III. 6, V. 4

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Njeh llojet e kapjeve dhe ndarjen e tyre.
- Përshkruar rëndësinë e teknikës në finalizimin e aksionit në xhudo

Kriteret e suksesit:

- Përshkruan llojet e kapjeve
- Ndërron llojin e kapjeve varësisht nga pozita dhe lëvizjet e kundërshtarit

FJALËT KYÇE:

Kapje, qëndrim, dora, krahu, lëvizje, hap etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit,

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizikë, Jeta dhe puna


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

Vrapim në kolonë, kompleks i ushtrimeve të formimit në çifte, shtyrje, tërheqje, si dhe ushtrime për të zhvilluar ekuilibrin.

PJESA KRYESORE

- Nxënësit vendosen në dy rreshta përballë njëri-tjetrit
- Mësimdhënësi shpjegon llojet e kapjeve në xhudo, rolin e tyre dhe demonstroi formën e ekzekutimit
- Nxënësit ofrohen mes vete, marrin qëndrimin **shizentai** dhe ekzekutojnë kapjen (kumikate), kapjen e ekzekutojnë njëkohësisht të dy nxënësit.
- Ushtrimin e njëjtë por tani nga qëndrimi mbrojtës i ulët – **jogitai**
- Përsëritën ushtrimet duke i kombinuar me forma të ndryshme të lëvizjeve (vrapime, shtrirje, kthim për 180 dhe 360 shkallë dhe të ngjashme
- Në mënyrë të njëjtë, por ndërrohen llojet e kapjeve (kapja e dy jakëve, kapja për dy mëngët etj.),
- Ushtrimet bëhen më fuqishëm duke tërhequr- shtyrë kundërshtarin dhe duke provuar për t'u liruar nga kapjet.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit me radhë bëjnë ekzekutimin e kapjes kumi-kate dhe analizojnë gabimet eventuale.

AKTIVITETE SHITESË

Nxënësit gjejnë dhe përshkruajnë format e tjera të kapjeve që nuk janë përmendur dhe demonstruar (e bëjnë detyrë shtëpie)

VLERËSIMI

Vlerësohet puna individuale e nxënësve, evidentohen ata që ekzekutojnë mirë si dhe ata që shfaqin vështirësi.

TEMA 3

Sporte Individuale - **XHUDO**

Fusha: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Shkalla: **3** Klasa: **VII**

TEMA:

Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në sportet luftarake

NJËSIA MËSIMORE : Bllokimet me duar- sote-uke, uchi ude-uke

RNSH: I. 6 III, 3 IV. 2, V. 4, VI. 1

RNF: *Demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përforcuar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Përshkruan teknikën e hedhjeve dhe shpjegon specifikat e ekzekutimit
- Ekzekuton saktë teknikën e plotë

Kriteret e suksesit:

- Kupton rolin e pozicionimit para hedhjes si dhe rolin kapjes së drejtë.
- Interpreton secilën lëvizje paraprake, para se të bëhet hedhja.

FJALËT KYÇE:

Trupi, qëndrim, kapje, hyrje, hedhje, rrotullim lëvizje etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, salla, dyshekë gjimnastikore

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizikë, Jeta dhe puna

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

Vrapim në kolonë, kompleks i ushtrimeve në çifte, në formë garuese duke demonstruar forcën statike dhe dinamike, si dhe forma të ushtrimeve të drejtpeshimit, ku e sfidojnë njëri-tjetrin për ta nxjerrë nga ekuilibrit

PJESA KRYESORE

Nxënësit ndahen në dy rreshta (çifte), përballë njëri-tjetrit

- Mësimdhënësi shpjegon llojet e formën e hedhjes (**nage-ëaza**) në xhudo, rolin e tyre dhe demonstroi formën e ekzekutimit.
- Nxënësit ofrohen mes vete, marrin qëndrimin **shizentai** dhe ekzekutojnë kapjen (kumikate), bëjnë hap para dhe vendosin këmbën mes këmbëve të kundërshtarit, dhe kthehen në pozicion fillestar, ushtrimin e përsërisin në formë alternative
- Ushtrimi i njëjtë por tani hapi bëhet më shpejt dhe kthimi anash duke futur kërdhokullat në trupin e kundërshtarit kurse me duar tërheqim.
- Ushtrimi tjetër bëhet duke e tërhequr më fuqishëm dhe shkëputur nga dyshemeja për pak cm. – përgatitje për hedhje.
- Ushtrimi i plotë por tani me radhë dy nga dy, njëri nxënës hidhet, kurse tjetri nuk reziston, ushtrim bëhet në dyshekët e trashë gjimnastikorë.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Dy rreshtat zgjedhin nga një përfaqësues për ta ekzekutuar hedhjen, cili po e bën më bukur dhe më shpejt, në formë gare, e bëjnë 3-4 nxënës.

AKTIVITETE SHITESË

Të tregojnë llojet e hedhjeve në xhudo dhe pikëzimin e tyre – detyrë

VLERËSIMI

Vlerësohet mënyra e ekzekutimit për secilin nxënës, evidentohen nxënësit që kanë vështirësi në ekzekutim të ushtrimit.

TEMA 1

Sporte individuale – **Tenis**

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti **Fusha:** _____ **Lënda:** _____ **Shkalla:** 3 **Klasa:** VII

TEMA:

Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në sporte individuale: ping-pong, tenis, badminton

NJËSIA MËSIMORE : Shërbimi

RNSH: III, 3 V. 4, VI. 1

RNF: *Demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përforcuar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Kupton mënyrën e shërbimit dhe lëvizjen e topit
- Njeh rregullat e shërbimit dhe pikëzimit.

Kriteret e suksesit:

- Merr pozicion dhe qëndrim të drejtë
- Shtrin trupin dhe krahun lart
- Ekzekuton lëvizjen e plotë

FJALËT KYÇE:

Pozita, topi, dora, lëvizja, krah, shërbimi, shtrirje etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, salla/poligon i hapur, reketi, topa tenisi

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizikë, Jeta dhe puna

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE


PJESA HYRËSE

Nxënësit në 6 grupe bëjnë garë stafetare në gjerësi të sallës/poligonit, duke manovruar me fluturën në lëvizje (zhonglim)

PJESA KRYESORE

Nxënësit ndahen në 4 grupe në poligon nga 4- 6 nxënës

- Mësimdhënësi shpjegon shërbimet, rolin, pastaj demonstroi teknikën e shërbimit bazik.
- Nxënësit të vendosur në kolona të vendosur në dy anët fundore të fushës ekzekutojnë me radhë teknikën– lëvizjen e krahut pa top, vetë, me reket
- Ushtrimi i njëjtë por tani e hedhin topin lart, por nuk e goditin vetëm bëjnë hap para dhe imitojnë goditjen-shërbimin
- Ekzekutojnë shërbimin me goditje të lehtë, sa e dërgojnë topin përtej rrjetës
- Nxënësit vendosën në dy kolona diagonale dhe provojnë të shërbejnë në zonën e shërbimit në mënyrë alternative, njëra kolonë dhe tjetra



PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit analizojnë lëvizjet në shërbim dhe përparësitë e njërit dhe tjetrit sipas rastit

AKTIVITETE SHITESË

Për të rritur kohën aktive të nxënësve, në të njëjtën kohë zhvillohet edhe badminton apo ping-pong (veçanërisht në kushte me mjete jo të mjaftueshme për të gjithë nxënësit)

VLERËSIMI

Vlerësohen lëvizjet individuale të nxënësve, duke përmirësuar në vazhdimësi gabimet bazike të nxënësve gjatë procesit

TEMA 1

Sporte individuale – Ping-pong

Fusha: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Lënda: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA:

Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në sporte individuale: ping-pong, tenis, badminton

NJËSIA MËSIMORE : Shërbimi – forhad dhe bachknad

RNSH: III, 3 V. 4, VI. 1

RNF: *Demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përforcuar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Njeh llojet e shërbimeve në raport me mënyrën e goditjes
- Kupton specifikat e llojeve të shërbimeve (të shkurta, me rrotullim të topit-spin, të gjata)

Kriteret e suksesit:

- Merr pozicion dhe qëndrim të drejtë
- Lëviz dorën saktë në të dyja teknikat (forhad dhe back hand)
- Shpjegon dallimet mes shërbimit të shkurtë dhe të gjatë – përparësitë dhe të metat

FJALËT KYÇE:

Pozita, topi, dora, lëvizja, shërbimi, rrotullim etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, tavolina, ping pongu, reketi, topa.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizikë, Jeta dhe puna

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

Nxënësit luajnë ping-pong, vetëm me nga 10 goditje të pandërprera, (në dyshe) duke u liruar hapësirën nxënësve të tjerë, këtë e bëjnë disa herë duke shpejtuar ritmin.

PJESA KRYESORE

Nxënësit vendosën pranë tavolinave të ping-pongut

- Mësimdhënësi shpjegon shërbimet, rolin dhe llojet e tyre, pastaj demonstroi teknikën e shërbimit bazik me frohand (shërbimi i gjatë pa rrotullime)
- Nxënësit në dyshe ekzekutojnë me radhë teknikën (njëri shërben tjetri i kthen, ky e kap me dorë dhe shërben sërish), provojnë 4-5 herë në mënyrë alternative.
- Ushtrimi i njëjtë por tani me variante (luajnë 3-4 goditje), shërben një herë njëri, një herë tjetri
- Ushtrimet në formën e njëjtë duke ekzekutuar teknikën backhand, përsëriten në mënyrë alternative.
- Nxënësit bëjnë lojë deri në 6 pikë duke përdorur shërbimin, një herë forfhand, një herë backhand



PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit analizojnë lëvizjet në shërbim dhe përparësitë e njërit dhe tjetrit, sipas rastit

AKTIVITETE SHITESË

Për të rritur kohën aktive të nxënësve, në të njëjtën kohë zhvillohet edhe badminton në poligonin/sallën (veçanërisht në kushte me mjete jo të mjaftueshme për të gjithë nxënësit)

VLERËSIMI

Vlerësohen lëvizjet individuale të nxënësve, duke përmirësuar në vazhdimësi gabimet bazike të nxënësve gjatë procesit.

TEMA 1

Sporte individuale – Badminton

Fusha: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA:

Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në sporte individuale: ping-pong, tenis, badminton

NJËSIA MËSIMORE : Shërbimi – forhad dhe bachknad

RNSH: III, 3 V. 4, VI. 1

RNF: *Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përforcuar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Njeh llojet e shërbimeve në raport me mënyrën e goditjes
- Kupton specifikat e llojeve të shërbimeve (të shkurta, me rrotullim të topit-spin, të gjata)

Kriteret e suksesit:

- Merr pozicion dhe qëndrim të drejtë
- Lëviz dorën saktë në të dyja teknikat (forhad dhe back hand)
- Shpjegon dallimet mes shërbimit të shkurtë dhe të gjatë – përparësitë dhe të metat

FJALËT KYÇE:

Pozita, topi, dora, lëvizja, shërbimi, rrotullim etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, salla me 3 poligone, reketi,

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizikë, Jeta dhe puna

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE


PJESA HYRËSE

Nxënësit në 6 grupe bëjnë garë stafetare në gjerësi të sallës/poligonit, duke manovruar me fluturën në lëvizje (zhonglim)

PJESA KRYESORE

Nxënësit ndahen në 3 poligone pune me nga 4- 6 nxënës

- Mësimdhënësi shpjegon shërbimet, rolin dhe llojet e tyre, pastaj demonstroi teknikën e shërbimit bazik me frohand
- Nxënësit në dyshe ekzekutojnë me radhë teknikën me radhë (njëri shërben, tjetri i kthen, ky e kap me dorë dhe shërben sërish), provojnë 4-5 herë në mënyrë alternative
- Ushtrimi i njëjtë por tani me variante (luajnë 3-4 goditje), shërben një herë njëri, një herë tjetri
- Ushtrimet në formën e njëjtë duke ekzekutuar teknikën backhand, përsëriten në mënyrë alternative.
- Nxënësit bëjnë lojë deri në 6 pikë duke përdorur shërbimin njëherë forfhand, njëherë backhand.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit analizojnë lëvizjet në shërbim dhe përparësitë e njërit dhe tjetrit, sipas rastit

AKTIVITETE SHITESË

Për të rritur kohën aktive të nxënësve, në të njëjtën kohë zhvillohet edhe tenis apo ping-pong (veçanërisht në kushte me mjete jo të mjaftueshme për të gjithë nxënësit)

VLERËSIMI

Vlerësohen lëvizjet individuale të nxënësve, duke përmirësuar në vazhdimësi gabimet bazike të nxënësve gjatë procesit

TEMA 1

Roli i sportit në shëndet dhe mirëqenie garave në shkollë

Fusha: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Lënda: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA:

Sportet, roli dhe ndikimi në shëndet dhe mirëqenie

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Analizon vlerat si barazia, diversiteti, respekti, pranimi, toleranca, gjatë aktiviteteve apo debateve në klasë dhe mjedis etj.

NJËSIA MËSIMORE : Organizimi i garave në nivel shkolle

RNSH: II. 5, III. 3, IV. 7, V. 4, VI. 1, 4, 6

RNF: *Shpjegon dhe analizon veprime konkrete për ruajtjen e mirëqenies fizike, psikike, emocionale dhe sociale të tij/saj dhe të tjerëve si në familje, me kolegët dhe anëtarët e komunitetit në situata të ndryshme.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Kupton karakterin e garave dhe konkurrencës përgjatë tyre
- Menaxhon emocionet në situata delikate pakënaqësie dhe gëzimi

Kriteret e suksesit:

- Organizon dhe kryen detyra në kuadër të ekipit/klasës
- Tregon respekt për nxënësin/ekipin rival si dhe bashkëlojtarët
- Manifeston kulturë dhe interesim për të marrë detyra konkrete në organizim dhe mbarëvajtje të garave

FJALËT KYÇE:

Gara, ekipi, kujdesi, konkurrenca, takim, fituesi, urimi etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, rregulloret e garave, kronometër, salla/poligon i hapur, topa etj.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, Biologji, Fizikë, Jeta dhe puna, Edukim për paqe dhe tolerancë, barazi gjinore

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

- Kërkohej nga nxënësit që të përshëndeten mes vete dhe u shpjegohet qëllimi i kryesor i garave.
- U shpjegohen rregullat dhe respektimin i plotë i vendimeve dhe qëndrimi që duhet treguar në raport me shokët dhe organizmin në përgjithësi.

PJESA KRYESORE

- Paraprakisht, është bërë hedhja e shortit (si formë standarde e organizmit të garave), dhe është përdorur sistemi standard i garave (varësisht nga sporti);
- Garën e referon mësimdhënësi dhe kujdeset që të jetë sa më i saktë në vendimet e tij, në mënyrë që pakënaqësitë të jenë sa më të vogla;
- Kujdeset që të ndajë shpërblime, mirënjohje për fituesit;
- Përfshin nxënës në organizimin e garës në detyra të ndryshme (mbajtje të uniformave, shënim të pikëve, ndihmë në referim dhe detzra të ngjashme).



PJESA PËRFUNDIMTARE

- Shpallje e fituesve dhe ndarje e shpërblimeve, si dhe falënderohen nxënësit për paraqitje dhe lojë korrekte.
- Gara mund të organizohet brenda një ore mësimore, por edhe jashtë orëve të rregullta.

AKTIVITETE SHITESË

- Nxënëseve u jepet detyrë që në formë të shkruar të propozojnë atë që mendojnë se duhet të ndryshohet në organizmin e një gare të radhës.

VLERËSIMI

- Vlerësohet angazhimi i përgjithshëm, duke evidentuar të arriturat më të mira për nxënësit e caktuar, korrektësia në paraqitje në garë, si dhe rezultatet.

TEMA 1

Aktivitete në ujë

Fusha: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Lënda: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA:

Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në not

NJËSIA MËSIMORE :

Aktivitete në ujë - kroli në shpinë

RNSH: I. 2 II. 5 III. 5, V. 4, VI. 3

RNF: *Demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake, not etj.), duke përforcuar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime të lëvizjeve dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Kupton shfrytëzimin e ligjeve të natyrës për të qëndruar në sipërfaqe të ujit;
- Harmonizon lëvizjet e krahëve, të këmbëve dhe të ritmit të frymëmarrjes.

Kriteret e suksesit:

- Shtrihet plotësisht në sipërfaqe të ujit dhe qëndron i relaksuar ;
- Ekzekuton lëvizje lehtë dhe pa u sforcuar/shtangur;
- Koordinon lëvizjet e këmbëve me të duarve.

FJALËT KYÇE:

Uji, lëvizja koordinimi, frymëmarrje, pozicioni, shtrirje etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, pishina.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, biologji, fizikë, jeta dhe puna.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

- Nxënësit ekzekutojnë pranë pishinës kompleks të ushtrimeve përgatitore;
- Nxënësit ecin në formë rrethore në kolonë, duke ndjerë rezistencën e ujit në trup, që bëhet në variante të ndryshme (anash, prapa, i përkulur etj.).

PJESA KRYESORE

- Nxënësit shtrihen në ujë plotësisht me krahë të shtrirë para (gjoks dhe në shpinë);
- Ushtrimi i njëjtë, lëviz vetë me këmbët lehtë (vetëm sa për të pluskuar mbi ujë);
- Nxënësit me duar të shtrira mbahen në tehun e pishinës, shtrihen plotësisht në ujë, ekzekutojnë lëvizjet me këmbë;
- Ushtrimi i ngjashëm, shtrirja në shpinë duke lëvizur vetëm këmbët, duart të mbështetura për trupi;
- Ushtrimi i njëjtë, por me lëvizje të krahëve në mënyrë alternative,
- Koordinimi i lëvizjes së krahëve, këmbëve dhe harmonizimi me frymëmarrje në mënyrë ritmike.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit me radhë rrotullohen nga kroi në gjoks në atë në shpinë, e përsërisin 2-3 herë ndërrimin e pozicionit.

AKTIVITETE SHITESË

Nxënësit që hasin në vështirësi në harmonizim të frymëmarrjes, ushtrojnë vetëm frymëmarrjen në vend, në tehun e pishinës për t'i përvetësuar lëvizjet.

VLERËSIMI

Vlerësohet evoluimi individual i secilit nxënës, evidentohen nxënësit që arrijnë rezultatet me të mira, si dhe përcaktohen detyrat shtesë për ata që hasin në vështirësitë e caktuara.

TEMA 1

Aktivitete në borë

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA:

Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në skijim.

NJËSIA MËSIMORE : Aktivitete në borë – kthesa me hap kah shpati

RNSH: I: 1. 2 II, 5 III. 5, V. 4, VI. 3

RNF: *Demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake, skijim etj.), duke përforcuar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime të lëvizjeve dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Kupton dhe shpjegon arsyen e bartjes së peshës trupore nga njëra këmbë në tjetrën;
- Interpretim ligjet fizike që ndihmojnë dhe vështirësojnë ekzekutimin e lëvizjeve në kthesë.

Kriteret e suksesit:

- Mban pozitën e drejtë të trupit në zbritje diagonale;
- Bart peshën trupore nga njëra këmbë në tjetrën;
- Kupton funksionin e lëvizjeve të caktuara në raport me drejtimin e lëvizjes.

FJALËT KYÇE:

Këmba, pesha , skitë, hapi, kthesa, zbritja, ndalja etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, shtegu i pjerrët, konet, skitë.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, biologji, fizikë, jeta dhe puna.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

- Nxënësit vendosen në rresht, njoftohen me llojet e aktiviteteve fizike që mund t'i realizosh në borë, me theks të veçantë te sporti i skijimit;
- Nxënësit vendosen në rresht në një ambient me pjerrtësi të lehtë, fillojnë ngjitjen drejt shpatit në formë anësore 3-4 hapa dhe zbresin duke rrëshqitur me këpucë.

PJESA KRYESORE

- Nxënësit ngjiten lart shpatit, lësohen drejt, duke e kombinuar me zbritje me teknikën pllugore;
- Ushtrimi i njëjtë, por tani duke shtuar kthesën pllugore;
- Zbritje diagonale me kthesë pllugore;
- Zbritje diagonale, kthesa themelore;
- Nga zbritja drejt, kthesë me hap kah shpati, duke bartur peshën trupore nga njëra këmbë në tjetrën, ndalje;
- Ushtrimi i njëjtë, tani nuk ndalemi plotësisht por me kthesë pllugore kthehemi në anën tjetër, duke kaluar nëpër pengesa (kone);
- Nga kthesa me hap kah shpati, në momentin që zvogëlohet shpejtësia, kalojmë në kthesën themelore në anën e tjetër, duke respektuar pengesat e vendosura me ngjyrë për kthimin në krahun e caktuar.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit analizojnë lëvizjet në shërbim dhe përparësitë e njëri- tjetrit sipas rastit.

AKTIVITETE SHITESË

Nxënësit që e zotërojnë teknikën më mirë ndahen dhe u jepet detyrë të kalojnë mes koneve, duke ua ndërruar distancën dhe këndin e kthesës.

VLERËSIMI

Vlerësohet përparimi individual i secilit nxënës, përcaktohen detyra shtesë për ata që shfaqin pengesa në procesin e nxënies së lëvizjeve të caktuara.

TEMA 1

Sporte Kolektive – Basketboll

Fusha: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive - basketboll

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:
Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në basketboll

NJËSIA MËSIMOR : Pasimet nga vendi, dhe në lëvizje

RNSH: I. 2, III. 3, 8, IV. 8, V. 4, VI, 1

RNF: *Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Demonstroi elementet teknike të pasimeve në basketboll;
- Përmirëson gabimet gjatë demonstrimit të teknikes së pasimit.

Kriteret e suksesit:

- Realizon pasimet me dy duar nga gjoksi;
- Realizon pasimet me dy duar mbi kokë dhe me një dorë;
- Demonstroi teknikën e lëvizjes së duarve dhe bartjen e peshës në anën e hapit të këmbës;

FJALËT KYÇE:

Topi, këmbët, duart, lëvizja, pranimi, pasimi etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

www.youtube.com/watch?v=Sc8ktctLxLQ

Libri i nxënësit, topa basketbolli 4x1, salla.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, fizikë, biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE , , Gjuajtës me top”


Mund të luhet në sallë dhe në terrene të hapura.

Dy nxënës gjuajtës gjenden në mes të fushës. Në shenjën e caktuar , gjuajtësit “ marrin topat dhe përpiqen t’i godasin nxënësit e tjerë, të cilët vrapojnë nëpër sallë. Secili që goditet me top, del nga loja më tutje.

PJESA KRYESORE

Pasimi i topit në lojën e basketbollit është një element teknik prej të cilit më së shumti varet mënyra e lojës. Dallojmë shumë lloje të pasimeve, të cilat gjejnë zbatim të vetin në lojën e basketbollit, e që duhet te realizohen me përqendrim të madh.

- Pasimet e topit në çifte nga vendi dhe lëvizja;
- Pasimet në trekëndësh dhe në katrorë,
- Pasimet e topit përballë kolonës, pas pasimit lojtari (nxënësi) kalon mbrapa kolonës së ve;
- I njëjti ushtrim, por pasuesi kalon mbrapa kolonës përballë;
- Pasime me 2 lojtarë gjatë vrapimit;
- Pasimet me 3 e më shumë lojtarë gjatë vrapimit etj.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Debati me nxënës:

- Gabimet e paraqitura;
- Mundësitë e evitimit të tyre

AKTIVITETE SHITESË

Të ushtroni teknikat e pasimeve, sepse janë elementet themelore teknike në basketboll.

VLERËSIMI

Vlerësimi motivues
Lista e kontrollit
Vetëvlerësimi

TEMA 2

Sporte Kolektive – Basketboll

Edukatë fizike, sportet
Fusha: dhe shëndeti

Edukatë fizike, sportet
Lënda: dhe shëndeti

Shkalla: 3

Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive - Basketboll

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në basketboll

NJËSIA MËSIMOR : Driblimet me përballje pasive dhe aktive

RNSH: I. 2, III. 3, IV. 8, V. 4, VI, 1

RNF: *Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Emërton dhe demonstroi teknikën e driblmit me përballje pasive dhe aktive.

Kriteret e suksesit:

- Të mësosh udhëheqjen, pasimin, kapjen dhe gjuajtjen e kombinuar në kosh;
- Shembuj të ushtrimeve për përsosjen e teknikës së driblmit me përballje aktive dhe gjysmë aktive.

FJALËT KYÇE:

Hapi, topi, kërcimi, pranimi, gjuajtja, udhëheqje etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: www.youtube.com/watch?v=Sc8ktctLxLQ

Libri i nxënësit, topa basketbolli 4x1, kone të ultë, salla.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, fizikë, biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE



PJESA HYRËSE

Nxënësit vrapojnë rreth vijave të sallës, kërcejnë, në mënyrë që të bëhet përgatitja (ngrohja) e organizmit dhe kompleksi i ushtrimeve të formimit.

PJESA KRYESORE

Driblimi është element teknik. Gjatë kohës së driblimit të topit në vend, pesha e trupit është në të dyja këmbët. Në disa raste, kjo mund të jete në këmbën e përparme dhe të pasme, kurse trupi është në qëndrim të ulët dhe pak i mbledhur para.

- Dribimet në vend dhe në lëvizje;
- Dribimet në vijë të drejtë;
- Dribime të shpejta në vijë të drejtë;
- Dribime në mesë të pengesave;
- Dribimet me kundërshtarë pasivë, gjysmëaktivë;
- Dribim me kundërshtarë aktivë .



PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit ndahen në katër grupe përballë koshit, distanca 10m. Me komandën e mësimsdhënësit startojnë nga driblimi drejt koshit, ndalje hedhje në kosh. Ekipi i cili shënon 10 pikë, atëherë është fituese.

AKTIVITETE SHITESË

Mësimdhënësi u jep detyra nxënësve të ushtrojnë llojet e driblimesve.

VLERËSIMI

Vlerësimi motivues;
Lista e kontrollit dhe vlerësimi i
ndërsjellë.

TEMA 3

Sporte Kolektive – Basketball

Fusha: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive - Basketball

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:
Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në basketball

NJËSIA MËSIMOR : Gjuajtja e topit në kosh me shkëputje

RNSH: I. 2, II. 7, III. 3, 8, IV. 8, V. 4, VI, 1

RNF: *Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Demonstron teknikën e gjuajtjes së topit në koshë
- Eliminon gabimet gjatë ekzekutimit të gjuajtjes së topit në kosh me kërcim.

Kriteret e suksesit:

- Vendos në qëndrimin e basketballit drejt gjuajtjes në koshë
- Analizojmë saktë teknikën e gjuajtjes .

FJALËT KYÇE:

Hapi, kërcimi, pranimi, gjuajtja, udhëheqje etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: www.youtube.com/watch?v=Sc8ktctLxLQ

Libri i nxënësit.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, fizikë, biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

Të gjithë nxënësit me nga një top në dorë driblojnë nëpër vija të sallës, në ecje, në vrapim, dhe ushtrojnë për përgatitjen e organizimit që të zbatohen sa më lehtë ushtrimet.

PJESA KRYESORE

Ky element është tërheqës, mënyra e gjuajtjes së topit në kosh është i tillë që shputat nga ana e dorës, me të cilën realizohet gjuajtja, është më përpara dhe në drejtim të koshit. Shputa e pasme është e vendosur më anash dhe pesha është në të dyja këmbët. Shikimi i orientuar në kosh, topi qëndron lehtë në pëllëmbë të dorës, gishtat lehtësisht të zgjeruar, ndërsa dora tjetër është mbajtës i tipit. Pas hedhjes së topit, dora drejtohet në nyjën e bërrylit.

- Gjuajtja e topit në kosh me një dorë;
- Gjuajtja e topit lart (mbi kokë) në kërcim,
- Gjuajtja e topit në kosh në kërcim nga tabela në të dyja anët;
- Gjuajtja e topit në kosh me kërcim nga vijat e trapezit;
- Gjuajtja e topit në kosh në kërcim nga vija e gjuajtjes së lirë



PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit e ndarë në 4 grupe gjenden përballë koshave, pranë vijave të gjuajtjes së lirë, me komandën për hedhjen e topit në kosh nga mësimdhënësi. Kolona që shënon 10 pikë, është fitues.

AKTIVITETE SHITESË

Ushtroni teknikën e hedhjes së topit në kosh, nxënësit mund të informohen edhe në internet në vegzën (linkun) e lartshënuar.

VLERËSIMI

Vlerësimi formal
(lista e kontrollit, vetëvlerësimi, vlerësim në formë gojore duke i evituar gabimet.

TEMA 4

Sporte Kolektive – Basketball

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Fusha: _____ **Lënda:** _____ **Shkalla:** 3 **Klasa:** VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive - Basketball

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në basketball

NJËSIA MËSIMOR : Dy hapshi i vazhdueshëm, gjuajtje apo pasim

RNSH: I. 2, III. 3, 8, IV. 8, V. 4, VI, 1

RNF: *Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.*

Rezultatet e të nxënësit të orës:

- Dallon dhe demonstroi teknikën e dyhapëshit dhe dyhapëshit të vazhdueshëm;
- Eliminon gabimet gjatë ekzekutimit të teknikës së dyhapëshit të vazhdueshëm.

Kriteret e suksesit:

- Nga udhëheqja kalon në dy hapësh;
- Kupton natyrën e llogaritjes së hapave dhe aplikimin e drejtë gjatë lojës.

FJALËT KYÇE:

Hapi, topi, kërcimi, pranimi, gjuajtja, udhëheqje etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: www.youtube.com/watch?v=Sc8ktctLxLQ

Libri i nxënësit, topa basketbolli 4x1, kone të ultë, salla.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, fizikë, biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE


PJESA HYRËSE Lojë elementare : Në shtëpi (rrathë)

Nxënësit e shpërndarë në fushë, pranë vetes kanë të vendosur rrathët gjimnastikorë. Me shenjë të arsimtarit ata vazhdojnë të vrapojnë në qark përkaj rrathëve të vendosur në fushë. Me shenjën e dhënë nxënësit duhet të hyjnë brenda rrethit (shtëpi). Loja luhet me dalje, kur një nxënës del, hiqet një rreth.

PJESA KRYESORE

Dyhapëshi i vazhdueshëm, lejon dy takime me tokën pas pranimit të topit. Nga pranimi i topit, realizohet hapi me shtytje të këmbës së majtë. Në fazën e fluturimit pranohet topi dhe takimi me token, e njëjta mund të realizohet me këmbën e djathtë.

- Nxënësit të radhitur në kolonë pa topa, përballë janë vijat e shënuara për vendosjen e hapi të parë dhe të dytë, ushtrimet përsëriten edhe në pengesa të tjera si në vendin e vijave, janë shkopinjtë;
- Nxënësit e radhitur në kolonë, bëjnë kërcimin nga njëri dyshek në tjetrin, duke e hedhur hapin në gjatësi e jo në lartësi dhe hapi i dytë më i shkurtër, duke i shtrirë duart sikurse po pasohet topi;
- Nxënësit e radhitur në 4 kolona në krahun e djathtë të koshave, gjatë driblimit aplikojnë dyhapëshin e vazhdueshëm;
- I njëjti ushtrim, por tani nga krahu i majtë;
- Ushtrimi i njëjtë, por me pasim të topit.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit të ndarë në 4 kolona, garë në mes të grupeve, duke realizuar dyhapëshin e vazhdueshëm, numërojnë 10 pikë të shënuar më pas është fitues.

AKTIVITETE SHITESË

Mësimdhënësi u jep detyrë që të vazhdojnë me ushtrime për përf forcimin e dyhapëshit të vazhdueshëm.

VLERËSIMI

Vlerësimi motivues, Lista e kontrollit, Vlerësimi i ndërsjellët.

TEMA 5

Spporte Kolektive – Basketboll

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti **Fusha:** _____ **Lënda:** _____ **Shkalla:** 3 **Klasa:** VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive - Basketboll

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:
Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në basketboll

NJËSIA MËSIMOR : Mbrojtja individuale, taktikë e lojës

RNSH: I. 2, II. 7, III. 3, IV. 8, V. 4, VI, 1

RNF: *Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Dallon dhe demonstroi teknikën e mbrojtjes individuale;
- Eliminon gabimet gjatë demonstrimit të qëndrimeve të basketbollit.

Kriteret e suksesit:

- Ta përjetësosh me ushtrime teknikën e mbrojtjes, teknikën në basketboll
- Shpjegon së paku disa mënyra për aplikimin e mbrojtjes individuale në basketboll.

FJALËT KYÇE:

Hapi, topi, kërcimi, pranimi, gjuajtja, udhëheqje etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: www.youtube.com/watch?v=Sc8ktctLxLQ

Libri i nxënësit, kone të ultë, salla .

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, fizikë, biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

Nxënësit vrapojnë, kërcenë, rreth palestrës, në mënyrë që përmes vrapimit ta bëjnë përgatitjen (ngrohjen) e organizmit dhe zgjatjen e muskujve, duke filluar nga muskujt e qafës, të duarve, të gjymtyrëve të poshtme deri te shputa.

PJESA KRYESORE

Mësimdhënësi informon nxënësit për njësinë mësimore dhe paraqet para tyre rezultatet e të nxënësve, më pas demonstroi teknikën e mbrojtjes, duke filluar nga qëndrimet e basketbollit.

-Nxënësit e shpërndarë nëpër fushë, aplikojnë qëndrimin e mbrojtjes , më pas me komandën e mësimdhënësit startojnë lëvizjet , në të djathtë, në të majtë, diagonal mbrapa, diagonal para.

-I njëjti ushtrim, por lëvizjet në mbroje aplikohen me drejtimin e lëvizjes së duarve nga mësimdhënësi, pastaj edhe me thirrje të krahut (majtas, djathtas).

- Nxënësit e ndarë në çifte, të shpërndarë në sallë, njëri e ka rolin e mbrojtësit e tjetri të sulmuesit, mbrojtësi përcjell lëvizjet në drejtime të ndryshme të sulmuesit, pastaj nxënësit i ndërrojnë rolet.

- Nxënësit sulmues rreshtohen në vijën fundore të fushës me topa, driblojnë në drejtime të ndryshme, mbrojtësi më duar të lidhura mbrapa përcjell sulmuesin.

- I njëjti ushtrim, por mbrojtja 100 për qind aktiv.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit e ndarë në grupe, përballë koshave të sallës, aplikojnë lojën 1: 1, përforcimi i mbrojtjes.

AKTIVITETE SHITESË

Nxënësve, mësimdhënësi u jep detyrë që të ushtrojnë dhe të marrin informata nëpërmes internetit.

VLERËSIMI

Vlerësimi me listën e kontrollit, vlerësimi motivues,
Vlerësimi në formë gojore për lëvizjet e gabuara.

TEMA 6

Sporte Kolektive – Basketball

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti **Fusha:** _____ **Lënda:** _____ **Shkalla:** 3 **Klasa:** VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive - Basketball

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:
Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në basketboll

NJËSIA MËSIMOR : Finta pa top dhe me top, taktikë ë lojës

RNSH: I. I. 2, II. 5, III. 7, 8, IV. 8, V. 4,

RNF: *Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Dallon dhe demonstroi teknikën e lëvizjes mashtruese me top dhe pa top.

Kriteret e suksesit:

- Ekzekuton saktë teknikën e fintës (mashtimit) me top dhe pa top;
- Ushtron disa mënyra për ta realizuar teknikën fintës.

FJALËT KYÇE:

Hapi, topi, kërcimi, pranimi, gjuajtja, udhëheqje etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: www.youtube.com/watch?v=Sc8ktctLxLQ

Libri i nxënësit, topa basketbolli 4x1, kone të ultë, salla.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, fizikë, biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

Vrapime rreth palestrës, vrapime majtas-djathtas, vrapime prapa, më pas kompleksi i ushtrimeve të formimit, për përgatitjen (ngrohjen) organizmit, që sa më lehtë të aplikohen ushtrimet për pjesën kryesore të orës.

PJESA KRYESORE

Mësimdhënësi nxjerr para njohuri përmes pyetjeve:

Është finta në basketboll?

Cilat finta i dini? finta me top dhe pa top(e sulmit dhe në mbrojtjes)

Mësimdhënësi demonstroi lëvizjet e fintës me top dhe pa top.

-Vrapime pa top në mes të pengesave, mashtrim në të majtë depërtim në të djathtë.

-Nxënësit e ndarë në çifte, vëndosen përballë njëri tjetrit në distancë 10m, në mes është pengesë që aplikohen lëvizjet mashtruese, pa top dhe me top.

-Nxënësit e ndarë në tresh, nxënësi në mes është mbrojtësi, dy lojtarët e tjerë aplikojnë fintën e pasimit, nxënësit i ndrojnë rolet kohë pas kohe.

-Nxënësit vëndosen në grupe përballë koshit, në të dy anët e trapezit vëndosen pengesat, dy nxënës vëndosen në fund të vijës fundore për ta pasuar topin pas aplikimit të fintës për pranim të topit.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Në pjesën përfundimtare, përforcimi i lëvizjeve mashtruese në kushtet e lojës, 1: 1, 2: 2

AKTIVITETE SHITESË

Mësimdhënësi jep detyra për nxënësit që ta ushtrojnë teknikën e lëvizjeve mashtruese, mashtrimit sepse ka rol të rëndësishëm në lojën e basketbollit

VLERËSIMI

Vlerësimi i ndërsjellët, mësimdhënësi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në lista të kontrollit, gjatë gjithë kohës arsimtari i eviton gabimet që i vëren te nxënësi.

TEMA 7

Sporte Kolektive – **Basketboll**

Edukatë fizike, sportet
Fusha: dhe shëndeti Edukatë fizike, sportet
Lënda: dhe shëndeti **Shkalla:** 3 **Klasa:** VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive - Basketboll

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:
Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në basketboll

NJËSIA MËSIMOR : Depërtimi me kthime rreth vetës (**pivotimi-boshti**)

(Pivot = mund ta quajmë edhe Qarkullues)

RNSH: I. 2, II. 7, III. 5, IV. 8, V. 4,

RNF: *Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Demonstroi në mënyrë të saktë teknikën e kthimit rreth vetës (pivotimin);
- Eliminon gabimet gjatë demonstrimit të teknikës së kthimit.

Kriteret e suksesit:

- Realizon teknikën e kthimeve rreth vetës (pivotimi-boshti);
- Demonstroi disa mënyra për zbatimin e teknikës së kthimeve

FJALËT KYÇE:

Hapi, topi, kërcimi, pranimi, gjuajtja, udhëheqje etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: www.youtube.com/watch?v=Sc8ktetLxLQ

Libri i nxënësit, topa basketbolli 4x1, kone të ultë, salla.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, fizikë, biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE ,, Arushat dhe gjuetari”

Në mesin e fushës vendoset banka suedeze, mbi të cilën ndalen tre nxënës ,, arusha”. Nxënësit e tjerë janë ,, gjuetarë” dhe gjenden në distancë të caktuar prej “arushave”. Pas tyre, nxënësit e tjerë, të cilët i mbledhin topat dhe vrapojnë në vendin e shënuar për ,, gjuetarët” ku përpiqen t’i godasin, , arushat”. Çdo ,, arushë” e goditur del prej loje. Gjatë kohës së lojës secili nxënës t’i provojë të dy rolet në lojë.

PJESA KRYESORE

Mësimdhënësi informon nxënësit për rëndësinë e kthimit rreth vetes në basketboll, më pastaj demonstron kthimin para dhe mbrapa.


-Të gjithë nxënësit më top në duar, nga vendi bëjnë lëvizjen para duke e zhvendosur këmbën luhatëse rreth vetes (boshtit).

- I njëjti ushtrim, por tani lëvizja prapa, duke e zhvendosur këmbën luhatëse prapa.

- Topin e hedhin lart, pas kapjes në kërcim, ndalje në qëndrim paralel, topi afrohet pranë trupit dhe lëvizje para dhe rreth boshtit të vet.

-DY nxënës të radhitur njëri pas tjetrit, driblon me top në drejtime të ndryshme dhe ndalet befás, lëvizje me kthim para apo prapa rreth vetes nga distanca e ndaljes pason bashkëlojtarit te vet.

-Lëvizja rreth boshtit (pivotimi) tani aplikohet në formë të lojërave stafetare, gjatë driblimit, me ndërrime nga dora e djathtë në të majtë, por me lëvizje mbrapa rreth vetes.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Përforcimi i pivotimit-boshtit , duke e aplikuar lojën 3: 3, rregulli i lojës që para gjuajtjes , driblimit dhe pasimit të aplikohet pivotimi

AKTIVITETE SHITESË

Mësimdhënësi jep detyrë që secili nxënës të merr informata në internet, gjegjësisht në linkun e lartshënuar dhe të ushtrojë lëvizjet rreth vetes.

VLERËSIMI

Vlerësimi motivues, vlerësimi me listën e kontrollit, vlerësimi i ndërsjellët.

TEMA 8

Sporte Kolektive – Basketboll

Fusha: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive - Basketboll

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:
Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathhtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në basketboll

NJËSIA MËSIMOR : lojë në grupe me aplikimin e elementeve të mësuara

RNSH: I. 3, III. 6, V. 4, V. 1

RNF: *Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathhtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Demonstroi teknikat e elementeve në mënyrë të sakta.
- Respekton rregullat e lojës.

Kriteret e suksesit:

- Respekton punën në grupe
- Shoqërimi në lojë dhe jashtë loje
- Zhvillon marrëdhëniet korrekte me nxënësit tjerë

FJALËT KYÇE:

hapi, topi, kërcimi, pranimi, gjuajtja, udhëheqje etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE: www.youtube.com/watch?v=Sc8ktctLxLQ

Libri I nxënësit, topa basketbolli 4x1, konat për kufizim të fushës

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, fizikë, biologji. Edukatë qytetare

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

Nxënësit vrapojnë rreth sallës, kërcime, me pas kompleksi i ushtrime të formimit për përgatitjen (ngrohjen) e organizmit.

PJESA KRYESORE

- Nxënësit e ndarë në grupe, grupet e shpërndarë në katër anët ku gjinden koshat, loja luhet 2: 2, 3: 3;
- loja aplikohet vetëm më pasime dhe me dy pikë loja fitohet bëhet ndërrimi i grupit;
- loja do të aplikohet me pasime dhe vetëm me një takim në doke;
- loja 3 me 3, të aplikohen të gjitha teknikat e mësuara.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Garë për precizitet, ekipi që shënon 10 pikë, pas shenjës së mësimdhënësit, është fituese.

AKTIVITETE SHITESË

Në fund të orës mësimore mësimdhënësi jep detyrat për nxënësit;
Harto një plan grupor për organizimin e një aktiviteti sportiv në sportin e basketbollit.

VLERËSIMI

- Nxënësi gjatë orës mësimore do të vlerësohet për angazhimin rreth njësisë mësimore;
- Vlerësimi i ndërsjellë , pjesëmarrje aktive në orën mësimore, mësimdhënësi gjatë orës vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit.

TEMA 1

Sporte Kolektive – **FUTBOLL**

Fusha: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Lënda: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive - Futboll

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:
Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në futboll.

NJËSIA MËSIMOR : Udhëheqjet me top

RNSH : I. 3, III. 6, V. 4, VI. 3

- Përgatitja e organizmit për pjesën kryesore të orës përmes ecjes, vrapimit, kërcimit dhe ushtrimeve të formimit. Mësimdhënësi shpjegon dhe demonstroi disa mënyra të shërbimit nga lart.

PJESA KRYESORE

- Mësimdhënësi përsërit teknikën e shërbimit nga lart, pasi kjo teknikë është mësuar në klasë të gjashtë;
- Nxënësit të vendosur përballë njëri –tjetrit e bëjnë imitimin e shërbimit;
- Nxënësit të vendosur përballë murit në distancë 5-6 metra godasin topin për muri, ushtrimi i njëjtë, mirëpo e rrisim distancën;
- Nxënësit vendosen në fushë në zonën e sulmit, nga aty e bëjnë shërbimin, pasi ta kenë përvetësuar teknikën e shërbimit, e ngrehim rrjetën dhe e bëjmë shërbimin nga vija fundore;
- Këto ushtrime i bëjmë nga shërbimi tenis, harkor, valëvitës.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit zhvillojnë lojën e precizitetit, ku me këtë shërbim duhet ta dërgojnë topin në cakun e kërkuar nga bashkëlojtari. Loja zhvillohet në dyshe, ku secili nxënës gjatë lojës shpjegon dhe komenton teknikën e shërbimit.

AKTIVITETE SHITESË

Në fund të orës mësimdhënësi jep detyra për nxënësit që të marrin informata më të gjera rreth shërbimit nga lart në ueb faqe.

VLERËSIMI

Nxënësi gjatë orës mësimore do të vlerësohet për angazhimin rreth njësise mësimore;

Vlerësimi i ndërsjellë, pjesëmarrje aktive në orën mësimore, mësimdhënësi gjatë orës vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit.

TEMA 8

Sportet kolektive - **Volejboll**

Fusha: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive - Volejboll

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në volejboll.

NJËSIA MËSIMOR : Loja me grupe ekipore

RNSH: I. 2 IV. 4, 5 V. 4

RNF: *Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Demonstroi teknikat e elementeve në mënyrë të saktë;
- Respekton rregullat e lojës.

Kriteret e suksesit:

- Respekto rregullat e lojës;
- Demonstron në mënyrë të saktë teknikën e elementeve të mësuara.

FJALËT KYÇE:

Pasim, dëbim, gjuajtje, goditje, bllokim, shërbim, poen, set.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, <https://.google.com/search?q=volleyball+game+ëith+kids&tbm>, <https://sq.wikipedia.org/wiki/Volejboli>

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit, zhvillim personal dhe aftësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

Nxënësit fillojnë përgatitjen (nxehjen) trupit për aktivitetin sportiv, (ecje, vrapime, kërcime, ushtrime formimi).

PJESA KRYESORE

Ndeshjet luhen ndërmjet dy ekipeve me nga 6 lojtarë, ekipi përbëhet nga 12 lojtarë. Karakteristikë në lojën e volejbollit është së fushën në mes e ndan rrjeta. Loja fillon me shërbimin e topit në fushën e kundërshtarit, loja luhet me 3 sete të fituara. Në raste të rezultatit të barabartë të seteve p. sh 2: 2 luhet seti i pestë, seti fitohet kur arrihen 25 pikë; dy pikë diferencë. Seti i pestë luhet me 15 pikë. Referojnë dy deri katër gjyqtarë. Fusha është 9×18; ku në mes është rrjeta që e ndan fushën në dy pjesë të barabarta. Rrjeta është e gjerë 1 m e gjatë 9.5 -10 metra. Lartësia e rrjetës është 243 cm., për meshkuj (senior) 224 cm për femra(seniore).



PJESA PËRFUNDIMTARE

Në fund të orës mësimdhënësi bën vlerësimin e performancës së nxënësve se si e kanë ekzekutuar tekniken e elementeve gjatë lojës.

AKTIVITETE SHITESË

-Në fund të orës mësimore mësimdhënësi jep detyrat për nxënësit; Harto një plan grupor për organizimin e një aktiviteti sportiv në sportin e volejbollit.

VLERËSIMI

-Nxënësi gjatë orës mësimore do të vlerësohet për angazhimin rreth njësive mësimore;
-Vlerësimi i ndërsjellë, pjesëmarrje aktive në orën mësimore, mësimdhënësi gjatë orës vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit.

TEMA 1

Sporte Kolektive – **Hendboll**

Fusha: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Lënda: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA: Rregullat elementare dhe elementet teknike të sporteve kolektive.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:
Përshkruan rregullat elementare dhe demonstroi elementet teknike në hendboll.

NJËSIA MËSIMORE: Qëndrimet dhe llojet.

RNSH: I. 3, III. 1, IV. 5, V. 4, VI. 3

RNF: Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Merr pjesë aktive në kryerje të detyrave të dhëna.
- Kupton mënyrat e qëndrimit; llojet dhe pozitën e trupit
- Kupton mënyrën e qëndrimit të kombinuar.

Kriteret e suksesit:

- Vendoset saktë në pozicion,
- Arrin të marrë pozitën e qëndrimit;
- Analizon arsyen dhe përcakton situatat kur përdoret qëndrimi paralel, kur diagonal dhe i kombinuar.

FJALËT KYÇE:

Qëndrimet, topi, gjoksi, koka, pranimi, këmbët, goditja etj.

BURIMET: Libri i nxënësit, Youtube, fusha sportive, Stërvitja sportive në hendboll.

MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, topa hendbolli, kone të ulët

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, fizikë, biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE : Ecje dhe vrapim përreth sallës. Pastaj nxënësit përreth arsimtarit ekzekutojnë disa ushtrime formimi për përgatitjen e nyjeve, si dhe disa elemente të kërcimeve nga vendi për nyjet e shputave, nxehjen e organizimit dhe zgjatjen e muskujve.

PJESA KRYESORE

Qëndrimi i hendbollit është pozitë, në të cilën realizohen më tepër elemente në mbrojtje.

Qëndrimi i hendbollit mund të jetë me shputa të vendosura paralelisht. Gjerësia e këmbëve është pak më e gjerë se sa shpatullat, kurse pesha e trupit është në pjesët e përparme të shputës. Trupi është i shfaqur përpara dhe duart janë të ngritura në lartësi të shpatullave me pëllëmbët e kthyer para.

Qëndrimi diagonal i hendbollit: shputat janë të vendosura në mënyrë diagonale.


Përkatesisht njëra shputë është më përpara për gjysmë hapi në lidhje me shputën tjetër.

Gjunjtë janë të mbledhur, kurse pesha e trupit është më tepër në këmbën e pasme.

Në varësi se me cilën dorë kundërshtari e realizon goditjen në gol, dallohet vendosja e qëndrimit të majtë apo të djathtë diagonal.

Edhe në të dyja qëndrimet gjatë lëvizjes duhet të kihet kujdes në këto gjëra:

distanca ndërmjet shputave çdoherë të jetë e njëjtë, mos të priset baraspesha dhe mos të kryqëzohen këmbët. Qëndrimi i kombinuar sipas situatës në lojë.



PJESA PËRFUNDIMTARE : Në pjesën përfundimtare, arsimtari u jep detyrë nxënësve, të cilët janë veguar në demonstrimin e qëndrimit paralel dhe diagonal që të demonstrojnë para nxënësve të tjerë me shpejtësi të ngadalësuar pa top dhe me top. Arsimtari i diskuton dhe u tregon nxënësve për gabimet eventuale dhe mundësitë e korrigjimit.

AKTIVITETE SHITESË :

Arsimtari, si aktivitet shtesë, u jep nxënësve detyrë që të krijojnë lidhjen në mes të qëndrimit paralel dhe diagonal, të ushtrojnë kalimin nga qëndrimi paralel në diagonal dhe nga diagonal në paralel.

VLERËSIMI

Vlerësimi motivues, Vlerësimi i ndërsjelle dhe lista e kontrollit, mësimdhënësi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe jep vërejtjet në formë gojore për lëvizjet e gabuara.

TEMA 2

Sporte Kolektive – **Hendboll**

Fusha: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Lënda: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive - Hendboll

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:
Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike

NJËSIA MËSIMOR : Pasimi dhe pranimet në vend dhe në lëvizje

RNSH: I. 3, III. 1, 6, IV. 5, V. 4, VI, 3

RNF: *Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Merr pjesë aktive në kryerje të detyrave të dhëna;
- Kupton mënyrat e pranimit të topit në lartësi;
- Kupton mënyrën e pasimit të topit në distanca të shkurta, të mesme dhe të gjata.

Kriteret e suksesit:

- Vendoset saktë në pozicion;
- Arrin ta qetësojë topin;
- Analizon arsyen dhe përcakton situatat kur përdoren pasimet e topave të lartë;
- Analizon mënyrën e kapjes së topit në distanca të ndryshme.

FJALËT KYÇE:

Qëndrimet, topi, gjoksi, koka, pranimi, goditja etj.

BURIMET: Libri i nxënësit, Youtube, fusha sportive, stërvitja sportive në hendboll.

MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, topa hendbolli, kone të ulët.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, fizikë, biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE : Nx' n' sit fillojn' p' r p' r gatitjen (nxehjen) e trupit p' r aktivitetin sportiv (vrapime, ecje, ushtrimet e formimit), m' simdh' n' si shpjegon dhe demonstroi s' pari tekniken e kapjes dhe t' udh' heqjes s' topit.


PJESA KRYESORE:

Pasimet me kohë, të shpejta dhe të sakta mundësojnë lojë të shpejtë, të sigurt dhe efikase. E përbashkët për të gjitha pasimet është ajo që duhet të realizohen me kujdes mjaft të madh. Pasimet duhet të jenë të shpejta, me kohë, të sakta dhe të paparashikueshme. Në hendboll mund të ketë pasime themelore dhe pasime specifike. Pasimet themelore mund të realizohen edhe me një dorë, siç janë: pasimi afër trupit, pasimi mbi kokë dhe pasime të tjera. Pasimet specifike mund të jenë: pasimi i topit pas kokës, ndërmjet këmbëve, pas shpine dhe pasime të tjera të paparashikueshme. Kapja e topit është një ndër elementet themelore gjatë trajnimit të teknikës me top. Kapja e topit realizohet ashtu që nxënësi i shtrin duart në drejtim prej nga vjen topi. Kontakti i parë me top realizohet me majat e gishtave, të cilët janë gjysmë të drejtuar dhe të orientuar kah topi, e pastaj edhe me pëllëmbë. Në këtë moment vjen në lakimin e njeve të bërrylave dhe tërheqjen e topit në gjoks që mundëson amortizimin e topit të pasuar.

Shembuj të ushtrimeve për ushtrimin e pasimit dhe kapjes së topit. Të gjitha ushtrimet realizohen në dyshe apo treshe:

Me qëndrimin paralel të hendbollit, me dorën e ngritur lart realizojmë pasim.

Me një hap përpara të njëres këmbë realizojmë pasim. Pasim në ecje, e pastaj edhe në vrapim. Pasim në kërcim.



PJESA PËRFUNDIMTARE : Nx' n' sit aplikojn' q' ndrim t' nd' rsjell' , arsimtari p' r dor informata kthyesë n' ato raste ku ka pasur v' shtir' si gjat' ushtrimit.

AKTIVITETET SHITESË t' kapjes dhe t' udh' heqjes së topit.

VLERËSIMI
*Vlerësimi motivues, vlerësimi i

Në fund të orës, mësuesi jep detyra për nxënësit, secili nxënës duhet ta hartojë një plan për organizimin e njohurive për kapjen dhe udhëheqjen e topit në mënyra të ndryshme.

ndërsjellë dhe lista e kontrollit;
Mësuesi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe jep vërejtjet në formë gojore për lëvizjet e gabuara.

TEMA 3

Sporte Kolektive – **Hendboll**

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti **Fusha:** _____ **Lënda:** _____ **Shkalla:** 3 **Klasa:** VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive -Hendboll

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në hendboll

NJËSIA MËSIMOR Kapja e topit me një dorë dhe dy duar në pozita dhe lartësi të ndryshme.

RNSH: I. 3, III. 1. 6, IV. 5, V. 4, VI. 3

RNF: Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Merr pjesë aktive në kryerje të detyrave të dhëna;
- Kupton mënyrat e kapjes me një dorë dhe dy duar topin në lartësi të ndryshme.
- Kupton mënyrën e vendosjes së duarve gjatë pranimi të topit.

Kriteret e suksesit:

Demonstroi teknikën e kapjes dhe të udhëheqjes së topit, duke përdorur mënyrën e përzgjedhur (me dorën e majtë apo të djathtë);
**Si bëhet mbajtja e duarve gjatë kapjes dhe udhëheqjes së topit;*
**Demonstroi pozitën e trupit gjatë kapjes së topit me duar.*

FJALËT KYÇE:

Qëndrimet, topi, gjoksi, koka, pranimi, goditja etj.

BURIMET: Libri i nxënësit, Youtube, fusha sportive, stërvitja sportive në hendboll.

MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, topa hendbolli, kone të ulët.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, fizikë, biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE :

Nx' n' sit fillojn' me p' rratitjen (nxehjen) e trupit p' r aktivitetin sportiv (vrapime, ecje, ushtrimet e formimit), nd' rsa m' simdh' n' si shpjegon dhe demonstroi s' pari teknik' n e kapjes dhe t' udh' heqjes s' topit.

PJESA KRYESORE :

Kapja e topit është një ndër elementet themelore gjatë trajnimit të teknikës me top. Kapja e topit realizohet ashtu që nxënësi i shtrin duart në drejtim prej nga vjen topi. Kontakti i parë me top realizohet me majat e gishtave, të cilët janë gjysmë të drejtuar dhe të orientuar kah topi, e pastaj edhe me pëllëmbë. Në këtë moment vjen lakimi i nyjeve të bërrylave dhe tërheqja e topit në gjoks që mundëson amortizimin e topit të pasuar.

Kapja e topit

Shembuj të ushtrimeve për ushtrimin e pasimit dhe të kapjes së topit. Të gjitha ushtrimet realizohen në dyshe apo treshe:

Me qëndrimin paralel të hendbollit me dorën e ngritur lart realizojmë pasim;

Me një hap përpara të njëres këmbë realizojmë pasim;

Pasim në ecje, e pastaj edhe në vrapim;

Pasim në kërcim.



Mbajtja e topit me dy duar

Shuplaka e dorës së majtë vihet në njërën anë, ndërsa shuplaka e dorës së djathtë në anën tjetër të topit, kurse gishtërinjtë e mëdhenj me gishtërinjtë tregues duhet të formojnë një lloj të trekëndëshit, ndërsa gishtërinjtë e tjerë vihen normalisht në top.

- **PJESA PËRFUNDIMTARE :** Nx' n' sit aplikojn' q' ndrim t' nd' rsjell' , arsimtari p' rdor informata kthyesë n' ato raste ku ka pasur v' shtir' si gjat' ekzekutimit t' kapjes dhe t' udh' heqjes s' topit.

AKTIVITETE SHITESË

Ne fund te orës mësimeve nxënësi jep detyra për nxënësit, secili nxënës duhet të hartojë një plan për organizimin e njohurive për kapjen dhe udhëheqjen e topit në mënyra të ndryshme.

VLERËSIMI

Vlerësimi motivues, vlerësimi i ndërsjellë dhe lista e kontrollit; Mësimeve gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe jep vërejtjet në formë gojore për lëvizjet e gabuara.

TEMA 4

Sporte kolektive – **Hendboll**

Fusha: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive - Hendboll

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në hendboll dhe përvetëson trehapëshin.

NJËSIA MËSIMOR : Përvetësimi i trehapëshit.

RNSH: I. 3, III. 1. 6, IV. 5, V. 4, VI. 3

RNF: *Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Merr pjesë aktive në kryerje të detyrave të dhëna;
- Kupton mënyrat e lëvizjes gjatë trehapëshit;
- Automatizon lëvizjen trehapësh.

Kriteret e suksesit:

- Vendoset saktë në pozicion;
- Arrin të qartësojë lëvizjen ;
- Analizon arsyen dhe përcakton situatat kur duhet të lëvizë me tre hapa.

FJALËT KYÇE:

Qëndrimet, topi, gjoksi, koka, pranimi, goditja etj.

BURIMET: Libri i nxënësit, Youtube, fusha sportive, stërvitja sportive në hendboll.

MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, topa futboll 2x1, kone të ulët.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, fizikë, biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

Më pas, arsimtari fillon shpjegimin për lëvizjet me top, përveç udhëheqjes është edhe trehapëshi i hendbollit, i cili për djathtakët fillon me këmbën e majtë, të djathtën pastaj të majtën, kujdes të veçantë duhet kushtuar hapit të parë dhe të tretë.

PJESA KRYESORE

**Udhëheqja e topit duhet bërë me shuplakën e dorës dhe topin duhet ta shtyjmë deri në atë masë sa topi të kthehet prapë te dora, kapim topin dhe ekzekutojmë trehapëshin.*

**Udhëheqja shërben për bartjen e topit prej një vendi në vendin tjetër, duke e përplasur me njëtrën dorë ose me tjetrën dhe ekzekutojmë trehapëshin.*

**Nxënësi me top në dorë ka të drejtë t'i bëjë më së shumti 3 hapa dhe pastaj ose duhet ta pasojë topin ose të kërcejë, ta shutojë në port.*

*** Nxënësi demonstroi trehapëshin duke ecur;**

*** Nxënësi demonstroi trehapëshin me vrapim të lehtë;**

***Nxënësi demonstroi trehapëshin duke udhëhequr topin;**

***Nxënësi pasi pranon topin me pasim nga distanca 5-7m, ekzekuton trehapëshin e hendbollit.**

PJESA PËRFUNDIMTARE: *Nxënësit në çifte vizatojnë fushën e hendbollit, bëjnë përmbledhjen e rregullave të hendbollit dhe vlerësimin e ndërsjellë me shokët e grupit për diçka që është bërë në mënyrën e duhur dhe për atë pjesë që duhet të përmirësohet.*

AKTIVITETE SHITESË

Në fund të orës mësuesi jep detyra për nxënësit, secili nxënës duhet ta hartojë një plan për organizimin e njohurive për lëvizjet bashkë me top në mënyra të ndryshme.

VLERËSIMI

**Vlerësimi motivues, vlerësimi i ndërsjelle dhe lista e kontrollit; Mësuesi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe jep vërejtjet në formë gojore për lëvizjet e gabuara.*

TEMA 5

Sporte Kolektive – **Hendboll**

Fusha: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Shkalla: **3** Klasa: **VII**

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive - Hendboll

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:
Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathhtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në Hendboll-gjuajtjen dhe kërcimin me tre hapa.

NJËSIA MËSIMOR : Gjuajtja nga trehapëshi me kërcim.

RNSH: I. 3, III. 1. 6, IV. 5, V. 4

RNF: *Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathhtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Merr pjesë aktive në kryerje të detyrave të dhëna;
- Kupton mënyrat e gjuajtjes me tre hapa;
- Kupton trehapëshin me kërcim

Kriteret e suksesit:

- Vendoset saktë në pozicion;
- Arrin ta qetësojë topin;
- Analizon arsyen dhe përcakton situatat kur përdoret trehapëshi, kërcimi dhe gjuajtja në portë.

FJALËT KYÇE:

Qëndrimet, topi, gjoksi koka, pranimi, goditja etj.

BURIMET: Libri i nxënësit, Youtube, fusha sportive, stërvitja sportive në hendboll.

MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, topa hendbolli, kone të ulët

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, fizikë, biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE . Nxënësit bëjnë përgatitjen e trupit përmes aktiviteteve sportive, si: udhëheqjen me top pa penguar njëri- tjetrin duke përdorur të gjitha pjesët e shpëtës, manovrimin, pasimet për muri, pastaj ushtrimet e formimit për nxehe.

PJESA KRYESORE :

Në lojën e hendbollit realizimi i goditjes në gol duhet të kalojë nëpër disa faza: hovin, kërcimin dhe fluturimin, hedhjen e topit dhe arritjen e kërcimit.

Goditjet në gol

Udhëheqja e topit realizohet me dorën që është e drejtuar dhe gjendet para trupit. Kur topi udhëhiqet në vend, atëherë pasimi realizohet me lëvizje të shkurtra me pëllëmbën prej lart poshtë, e nëse udhëhiqet në lëvizje, këndi i pasimit të topit varet nga shpejtësia e lëvizjes së nxënësit. Shembuj të ushtrimeve për ushtrimin e udhëheqjes së topit: Udhëheqja e topit në vend me dorën më të mirë, e pastaj edhe me çështjen e ndërsjellë dora e djathtë – e majtë.

Udhëheqja e topit në ecje dhe vrapim me njëren dorë, e pastaj edhe në mënyrë të alternuar dora e djathtë – e majtë.

Udhëheqja e topit zigzag.

Udhëheqja e topit në lëvizje me marrjen e topit nga ana e nxënësit tjetër. Shembuj të ushtrimeve për ushtrimin e goditjes në gol:

Nxënësit punojnë në çifte. Nga qëndrimi paralel bëjnë një hap dhe realizojnë goditje, me çka duhet të kihet kujdes në mbajtjen e drejtë të dorës. Dora shpejt lëviz përpara, kurse topi hidhet me gishta.

Ky ushtrim mund të realizohet edhe me hov, udhëheqje dhe kërcim.

Nxënësi realizon goditje në gol edhe pa kërcim, kur topin ia jep nxënësi tjetër.

Nxënësi realizon goditje në gol pa kërcyer apo në kërcim, pastaj nxënësi tjetër përpiqet ta pengojë.

Loja në dy gola, me goditje në gol, me kërcim dhe pa kërcim.



PJESA PËRFUNDIMTARE : *Në përgjithësi është realizuar e gjithë përmbajtja e planifikuar, duke përfshirë dy or mësimi dhe duke pasur parasysh detyrat e shtëpisë që u janë caktuar nxënësve.

AKTIVITETE SHITESË

Detyra: secili nxënës duhet të hartojë një plan për zhvillimin e shkathhtësive në demonstrimin e elementeve teknike të lojës së hendbollit dhe të hulumtojë ne ueb faqe për marrjen e informacioneve, për rregullat, për zbatimin e pasimit dhe të pranimit të topit.

VLERËSIMI

Vlerësimi motivues, vlerësimi i ndërsjellë dhe lista e kontrollit; Mësimdhënësi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe jep vërejtjet në formë gojore për lëvizjet e gabuara.

TEMA 6

Sporte Kolektive – **Hendboll**

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti **Fusha:** _____ **Lënda:** _____ **Shkalla:** 3 **Klasa:** VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive - hendboll

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:
Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathhtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në hendboll.

NJËSIA MËSIMOR : Lëvizjet e lojtarëve në zonën mbrojtëse.

RNSH: I. 3, III. 6, V. 4

RNF: *Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathhtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Merr pjesë aktive në kryerje të detyrave të dhëna;
- Kupton mënyrat e pranimit të topit në lartësi.

Kriteret e suksesit:

- Vendoset saktë në pozicion;
- Arrin ta qetësojë topin;
- Analizon arsyen dhe përcakton situatat kur përdoren pasimet e topave të lartë.

FJALËT KYÇE:

Qëndrimet, topi, gjoksi, koka, pranimi, goditja etj.

BURIMET: Libri i nxënësit, Youtube, fusha sportive, stërvitja sportive në hendboll.

MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, topa hendbolli, kone të ulët.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, fizikë, biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE Nxënësit bëjnë përgatitjen e trupit përmes aktiviteteve sportive, si: udhëheqjen me top pa penguar njëri-tjetrin duke përdorur të gjitha pjesët e shputës, manovrimin, pasimet për muri, pastaj ushtrimet e formimit për nxehje.

PJESA KRYESORE MBROJTJA NË ZONË

Zonat janë mënyra e luajtjes në mbrojtje. Te mbrojtja në zonë secili nxënës i ekipit e mbron një pjesë të hapësirës. Nxënësit janë të radhitur në vijë prej 6 m. Te kjo mënyrë e lojës në mbrojtje nxënësit nuk janë statikë (të palëvizshëm). Ata lëvizin anësh duke i përcjellë lëvizjet e ekipit tjetër. Në mbrojtjen e zonës nxënësit mund të vendosen në këto formacione: 6:0, 5:1 4:2, 3:3, dhe 3:2:1.

Lëvizja dhe marrja e pozitave të përshtatshme mbrojtëse;
Pengimi i gjuajtjes në portë;
Blloku në top;
Rrëmbimi, heqja apo prerja e topave.
Pengimi dhe ndërprerja e lëvizjeve të sulmuesit.

PJESA PËRFUNDIMTARE Nxënësit në çifte vizatojnë fushën e hendbollit, bëjnë përmbledhjen e rregullave të hendbollit dhe bëjnë vlerësim të ndërsjellë me shokët e grupit për diçka që është bërë në mënyrën e duhur dhe për atë pjesë që duhet të përmirësohet.

AKTIVITETE SHITESË

Secili nxënës duhet ta hartojë një plan për zhvillimin e shkathtësive, për rregullat e lojës së hendbollit dhe elementeve teknike të lojës së hendbollit, të hulumtojë në ueb faqe për marrjen e informacioneve për rregullat e lojës së hendbollit.

VLERËSIMI

Vlerësimi motivues, vlerësimi i ndërsjellë dhe lista e kontrollit;
Mësimdhënësi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe jep vërejtjet në formë gojore për lëvizjet e gabuara.

TEMA 6

Sporte Kolektive – **Hendboll**

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti **Fusha:** _____ **Lënda:** _____ **Shkalla:** 3 **Klasa:** VII

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive - Hendboll

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:
Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në hendboll

NJËSIA MËSIMOR : Lëvizja mashtruese finta me kthime rreth vetes “rolling” (qarkore) me tre hapa

RNSH: I. 3, III. 1, IV. 5, V. 4, VI. 3

RNF: Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Merr pjesë aktive në kryerje të detyrave të dhëna;
- Kupton mënyrat e mashtrimit finta;
- Kupton mënyrën e veprimit me “rolling”.

Kriteret e suksesit:

- Vendoset saktë në pozicion;
- Arrin ta bëjë trehapëshin;
- Analizon arsyen dhe përcakton situatat kur përdoret “rolingu” kur finta dhe trehapëshi.

FJALËT KYÇE:

Qëndrimet, gjoksi koka, pranimi, goditja etj.

BURIMET : Libri i nxënësit, Youtube, fusha sportive, stërvitja sportive në hendboll.

MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, topa hendbolli, kone të ulët.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, fizikë, biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

Pas evidentimit të pjesëmarrjes në mësim, nxënësit ecin dhe vrapojnë përreth sallës dy rrrathë. Ftohen nxënësit përreth arsimtarit dhe ekzekutojnë disa ushtrime formimi për përgatitjen e njejeve, si dhe disa elemente të kërcimeve nga vendi për njejt e shputave, nxehtjen e organizimit, zgjatjen e muskujve duke filluar nga muskujt e qafës, të duarve, të gjymtyrëve të poshtme dhe tërë trupit.

PJESA KRYESORE:

T' i kushtohet rëndësi e vëmendje teknikës së vrullit pa top, pranimi të topi, vazhdimi të vrullit me top, drejtimit, pozitë, lëvizjeve të krahëve, trupit dhe kokës.

Lëvizja mashtruese (finta) duhet të jetë veprim bindës, në mënyrë që lojtari mbrojtës të vihet në mashtrim që të zhvendoset, të largohet nga pozita e mirë mbrojtëse dhe t' i krijosh vetes pozitë të përshtatshme për sulm.

- Të ushtrohet finta e shpejtë në distancë 1 – 1.5m duke iu shmangur afërsisë së lojtarit mbrojtës. Finta mund të bëhet majtas dhe djathtas, sipas nevojës.



PJESA PËRFUNDIMTARE Nxënësit në çifte vizatojnë fushën e hendbollit dhe bëjnë përmbledhjen e rregullave të hendbollit, bëjnë vlerësim të ndërsjellë me shokët e grupit për diçka që është bërë në mënyrën e duhur dhe për atë pjesë që duhet të përmirësohet.

AKTIVITETE SHITESË

Arsimtari si aktivitet shtesë, u jap nxënësve detyrë që t'i ushtrojnë mashtrimet me vrull pa top, pastaj vazhdimin me top, si dhe në afërsi 1-1.5m, në anën e majtë dhe të djathtë.

VLERËSIMI

Vlerësimi motivues, vlerësimi i ndërsjellë dhe lista e kontrollit; Mësimdhënësi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe në formë gojore jep vërejtjet për lëvizjet e gabuara.

TEMA 8

Sporte kolektive – **Hendboll**

Fusha: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Lënda: Edukatë fizike, sportet
dhe shëndeti

Shkalla: **3** Klasa: **VII**

TEMA: Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive - Hendboll

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:
Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në hendboll

NJËSIA MËSIMOR : **Loja** - rregullat e lojës dhe referimi nga nxënësit

RNSH: I. 3, III. 6, V. 4

RNF: *Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.*

Rezultatet e të nxënësit të orës:

- Merr pjesë aktive në kryerje të detyrave të dhëna;
- Kupton mënyrat e pranimi të topit në lartësi;
- Përshkruan rregullat elementare dhe demonstroi elementet teknike në Hendboll.

Kriteret e suksesit:

Me top në dorë nuk guxojmë të ecim më shumë se tre hapa;

**Për ata nxënës që luajnë me dorë të djathtë, hapat fillojnë: e majta, e djathta dhe e majta, për të majtët: e djathta, majta dhe e djathta.*

**Gjuajtja në portë të bëhet pas shtytjes nga hapi i tretë dhe pa u futur në zonën e portierit.*

FJALËT KYÇE:

Qëndrimet, topi, gjoksi, koka, pranimi, goditja etj.

BURIME : Libri i nxënësit, Youtube, fusha sportive, stërvitja sportive në hendboll.

MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, topa hendbolli, kone të ulët.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, fizikë, biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE: *Rreshtimi i nxënësve, vrapim rreth fushës, nxehje dhe zgjatje e gjymtyrëve të sipërme dhe të poshtme, përgatitje për lojë, zgjatje dinamike dhe statike.*

PJESA KRYESORE

Loja e hendbollit në një gol apo në dy gola me zbatimin e rregullave, paraqet një aktivitet të planifikuar të ekipit, me qëllim që të gjejnë zgjidhje për shënimin e golit, e pastaj të mos shkelen rregullat e lojës.

Për përvetësim më të mirë të rregullave në lojën e hendbollit, zbatohet loja në një gol. Këtu nxënësit duhet t'i kushtojnë vëmendje të posaçme udhëheqjes së drejtë dhe pasimit të topit, përkatësisht, të mos vijë në udhëheqjen e gabueshme të topit (udhëheqja e dyfishtë është kur topi udhëhiqet dhe kur do të kapet me të dyja duart, ndalohet sërish të udhëhiqet), bërja e gabimeve në hapa (nuk guxon të bëhen më tepër se tre hapa me mbajtjen e topit në duar), depërtimi (faull në sulm) dhe shkelja brenda në hapësirë prej gjashtë metrash.

Kur nxënësit do t'i përvetësojnë rregullat themelore për lojë në një gol, shkohet me lojën me dy gola, me zbatimin e rregullave themelore të hendbollit.



PJESA PËRFUNDIMTARE : *Për ta vlerësuar përfitimin e njohurive nga ana e nxënësve, mësimdhënësi parashtron pyetjet: Çfarë kemi mësuar sot, sa hapa kemi të drejtë të ecim me top në dorë, me cilën këmbë i fillojmë hapat nëse luajmë me dorën e majtë, a kemi të drejtë të shkelim vijën apo të futemi në zonën e portierit(6 metërshi).*

AKTIVITETE SHITESË: **Në fund të orës mësimdhënësi jep detyra për nxënësit, secili nxënës duhet ta hartojë një plan për zhvillimin lojës së hendbollit dhe të elementeve teknike të lojës së hendbollit, të hulumtojë në ueb faqe për marrjen e informacioneve për rregullat e lojës së hendbollit.*

VLERËSIMI: Vlerësimi motivues, Vlerësimi i ndërsjellë dhe lista e kontrollit;
Mësimdhënësi gjatë orës mësimore vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit dhe jep vërejtjet në formë gojore për lëvizjet e gabuara.

TEMA 1**TË USHQYERIT E SHËNDETSHËM**

Edukatë fizike, sportet
Fusha: dhe shëndeti Edukatë fizike, sportet
Lënda: dhe shëndeti **Shkalla:** 3 **Klasa:** VII

TEMA:
Të ushqyerit e shëndetshëm

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Dallon llojet e ndryshme të ushqimit dhe njeh mënyrat e përdorimit të artikujve ushqimorë;
- Vlerëson shprehitë e tij në raport me sasinë dhe cilësinë e ushqimit.

NJËSIA MËSIMORE : Shprehitë e të ushqyerit

RNSH: I. : I.4,6, II,1, IV.2, V.1,2

RNF: *Hulumton sistemin e klasifikimit të ushqimit të etiketuar, kupton që njerëzit kanë nevojë të ndryshme për ushqim dhe nevojat e tyre ndryshojnë në etapa të ndryshme të jetës se si duhet të ushqehen.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Përshkruan shprehitë e të ushqyerit të shëndetshëm;
- Përshkruan përbërësit ushqimorë dhe analizon nevojën e tyre për organizmin e njeriut.

Kriteret e suksesit:

- Nevojën për shprehitë e rregullta të të ushqyerit;
- Njeh përbërësit bimorë dhe shtazorë të ushqimeve;
- Përshkruan manifestimin e përbërësve ushqimorë të konsumuar në mënyrë jo të rregullt.

FJALËT KYÇE:

Ushqimi, përbërja, shprehi etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, fleta pune të mëdha.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, biologji, fizikë, jeta dhe puna.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

- Nxënësit ndahen në 2 grupe, njëri grup do t'i përzgjedh shprehitë e të ushqyerit, kurse grupi tjetër do të përzgjedhë përbërësit ushqimorë, të ndarë në ata bimorë dhe shtazorë.

PJESA KRYESORE

- Nxënësit për 10 min. kryejnë detyrën sipas grupeve të dhëna më parë;
- Në 8 minuta prezantojnë punën nga një përfaqësues i grupit;
- Në 8 min. të tjerë i diskutojnë dhe i analizojnë idetë e grupit tjetër duke plotësuar apo duke kontestuar ndonjë nga idetë e tyre;
- Mësimdhënësi evidenton gjatë diskutimeve të tyre, plotëson atë që nxënësit nuk e kanë thënë;
- Bashkërisht analizojnë shprehitë e dëmshme të të ushqyerit dhe përkufizojnë përbërësit ushqimorë, duke analizuar ndikimin e tyre në organizëm.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Secili nga nxënësit tregon një shprehje të gabueshme të të ushqyerit apo përbërësit e ndonjë ushqimi të konsumuar në mënyrë jo të drejtë (të tepërt apo të pamjaftueshme).

AKTIVITETE SHITESË

- Nxënësit kanë për detyrë ta përshkruajnë sasinë optimale ditore të një përbërësi të caktuar ushqimor të zgjedhur sipas dëshirës (detyrë shtëpie).

VLERËSIMI

Vlerësohen në grup, pastaj individualisht sipas aktiviteti të prezantuar gjatë diskutimeve.

TEMA 1**Substancat që krijojnë varshmëri**

Shëndeti dhe mirëqenia

Fusha: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Lënda: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Shkalla: 3 Klasa: VII

TEMA:
Substancat që krijojnë varshmëri

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:
Krijon qëndrim refuzues ndaj duhanit, alkoolit, drogave dhe substancave të tjera.

NJËSIA MËSIMOR : Pasoja nga përdorimit i substancave narkotike

RNSH: I.2,7 II.1 V.4,8

RNF: Njeh dhe dallon situatat e rrezikshme, dukuritë dhe shprehjet negative (substancat negative: duhani, alkooli, drogat) dhe kupton mënyrën për parandalimin e tyre

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Merr pjesë aktive në kryerje të detyrave të dhëna;
- Kupton , dallon përparësitë dhe dobësitë e atyre që konsumojnë duhan dhe substanca narkotike më ata të cilët nuk konsumojnë.

Kriteret e suksesit:

- Pjesëmarrja aktive në realizimin e projektit;
- Shpjegon dhe prezanton projektin;
- Shpjegon së paku 3 pasoja që sjell përdorimi i duhanit dhe i substancave narkotike.

FJALËT KYÇE: duhani, substancat narkotike, dëmet, shëndeti.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, <https://www.google.com/search?q=duhani+tek+te+rinjte&source>

<https://www.google.com/search?q=substancat+narkotike+te+femijet&tbn>

Gjuhë dhe komunikim, zhvillim personal dhe aftësi për jetë, edukim për zhvillim të qëndrueshëm, arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

- Debat 5 minuta rreth dëmeve që i shkakton pirja e duhanit dhe e substancave narkotike;
- Nxënësve të ndarë në grupe u jepet detyrë të përgatisin nga një projekt.

PJESA KRYESORE

- Prezantim i temës: nxjerrim para njohuritë përmes pyetjeve të hapura, si;
- A krijojnë varshmëri pirja e duhanit, e alkoolit, e drogave dhe e substancat të tjera?
- A duhet njeriu të krijojë qëndrim refuzues ndaj këtyre shprehive të dëmshme për organizmin?
- Prezantohen punimet e nxënësve me nga 5 minuta (detyra e dhënë më herët);
- Mësimdhënësi e vlerëson punën e nxënësve dhe i plotëson nxënësit me informacione.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Nxënësit shprehin idetë e veta në formë të debatit se çfarë do të donin t'u thoshin duhanpirësve dhe atyre që konsumojnë lëndë narkotike.

AKTIVITETE SHITESË

- Në fund të orës mësimore mësimdhënësi jep detyra për nxënësit, secili nxënës duhet ta hartojë një plan për dëmet dhe parandalimin e këtyre dukurive negative të moshatarët e tyre.

VLERËSIMI

- Nxënësi gjatë orës mësimore do të vlerësohet për angazhimin rreth njësisë mësimore;
- Vlerësimi i ndërsjellë, pjesëmarrje aktive në orën mësimore;
- Mësimdhënësi gjatë orës vlerëson punën e nxënësve në listën e kontrollit.

TEMA 1

Dobitë e ambientit natyror

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Fusha: _____
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Lënda: _____
Shkalla: 3 **Klasa:** VII

TEMA:

Aktivitetet fizike në natyrë dhe rëndësia e mjedisit

REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMË:

- Vlerëson dobitë e shfrytëzimit të mjedisit natyror dhe mjediseve të mbyllura për aktivitete të ndryshme fizike dhe sportive.

NJËSIA MËSIMORE : Dobitë e të ushtruarit në ambient natyror

RNSH: I.4,6, II,1,8, III.5,IV,2,3 V.3,10

RNF: *Njeh burimet natyrore, rregullat e sjelljes në natyrë, në kampe dhe i shfrytëzon ato për zhvillim të aftësive fizike.*

Rezultatet e të nxënit të orës:

- Përshkruan dobitë e shfrytëzimit të mjedisit natyror për aktivitete të ndryshme fizike dhe sportive;
- Dallon përparësitë dhe dobësitë e shfrytëzimit të mjediseve artificiale.

Kriteret e suksesit:

- Numëron faktorët natyrorë të rëndësishëm për organizmin e njeriut;
- Tregon për dobitë konkrete të ajrit, dritës, etj. në trupin e njeriut;
- Përshkruan rreziqet nga ekspozimi jo i drejtë ndaj faktorëve natyrorë.

FJALËT KYÇE:

Natyra, dielli, ajri, uji, aktiviteti fizik, etj.

BURIMET, MJETET E KONKRETIZIMIT DHE MATERIALET MËSIMORE:

Libri i nxënësit, lapsa, fleta të mëdha pune.

LIDHJA ME LËNDËT E TJERA MËSIMORE DHE /APO ÇËSHTJET NDËRKURRIKULARE:

Gjuhë dhe komunikim, biologji, fizikë, jeta dhe puna.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE

PJESA HYRËSE

- Nxënësit ndahen në 4 grupe, 2 prej tyre u jepet detyrë t'i shkruajnë përparësitë e aktiviteteve fizike në sallë (ambiente të mbyllura), kurse 2 grupeve të tjera për aktivitet fizike në ambient të hapur, natyrë.

PJESA KRYESORE

- Nxënësit në 10 min. kryejnë detyrën sipas grupeve të ndara duke nxjerrë përparësitë e të ushtruarit në ambiente të hapura dhe të mbyllura;
- Në 8 minuta prezantojnë punën nga një përfaqësues i grupit;
- Në 8 min. të tjerë i diskutojnë dhe i kontestojnë idetë e grupeve rivale duke ofruar argumente të kundërta;
- Mësimdhënësi evidenton gjatë diskutimeve të tyre, plotëson atë që nxënësit nuk e kanë thënë, arsyeton mendimet e tyre dhe së bashku nxjerrin përfundimet mbi përparësitë e të ushtruarit në ambiente të hapura.



PJESA PËRFUNDIMTARE

Analizohen përparësitë e të ushtruarit në palestra, në salla dhe domosdoshmëria e ekzistimit të tyre, përkundër përparësive të ambientit të hapur.

AKTIVITETE SHITESË

Nxënësit përzgjedhin të analizojnë nga një faktor natyror, cili është roli i tij në organizëm dhe çfarë efekte prodhon.

VLERËSIMI

Vlerësohet puna në grupe, pastaj në kuadër të diskutimeve edhe në mënyrë individuale, vlerësohet angazhimi në diskutime dhe prezantim të punës.

